



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



RAPORTI VJETOR

PËR VITIN 2011

Shkurt 2012, Prishtinë

Përmbajtja

1. PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE GJATË VITIT 2011.....	4
a. Buxheti	4
b. Promovimi i zhvillimit ekonomik.....	5
c. Administrata komunale.....	6
d. Shëndetësia, arsimi dhe kultura.....	6
e. Infrastruktura dhe urbanizmi.....	7
f. Ndërmarrjet publike komunale.....	8
g. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.....	9
h. Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje:.....	9
i. Siguria publike	10
j. Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	10
2. MBLEDHJET E KUVENDIT, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE	11
3. AKTIVITETET E ZYRAVE	11
a. Zyra e përfaqësimit juridik.....	11
b. Zyra për auditim të brendshëm.....	12
c. Departamenti i Prokurimit	12
d. Zyra për marrëdhënie me publikun,.....	13
e. Zyra ligjore	13
f. Zyra Komunale për Integrim Evropian	14
g. Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.....	14
h. Zyra për kthim dhe komunitete	14
4. DREJTORIA E ADMINISTRATËS	15
a. Njësia e personelit	15
b. Sektori i punëve të përgjithshme	16
c. Sektori i bashkësive lokale.....	16
d. Sektori teknik	17
e. Sektori i gjendjes civile.....	17
f. Qendra e shërbimit për qytetar	18
5. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE	18
a. Të dhënat për stafin dhe shërbimet shëndetësore	19
b. Investimet kapitale.....	20
c. Mirëqenia Sociale.....	21
d. Bashkëpunimi me donatorët.....	23
6. DREJTORIA E ARSIMIT	24
a. Të dhëna për arsimin në Komunën e Prishtinës	24
b. Mbikëqyrja e procesit edukativ-arsimor.....	24
c. Shërbimi i administratës	24
d. Shërbimi i financave.....	25
e. Ngritja e infrastrukturës shkollore	25
f. Aktivitetet e tjera të drejtorisë.....	26
7. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	27
a. Investimet kapitale.....	27
b. Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme kulturore	28
c. Sektori për kulturë	28
d. Sektori për sport dhe rini.....	29
e. Institucionet kulturore ndër-komunale.....	29
8. DREJTORIA E FINANCAVE DHE PRONËS	30
a. Buxheti për vitin 2011	30
b. Të hyrat vetanake	30
c. Shpenzimet buxhetore	31
d. Sektori për buxhet dhe financa	33
e. Sektori i Tatimit në Pronë	33
f. Sektori i Pronës	34
9. DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT.....	35
a. Sektori i Ekonomisë.....	35
b. Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural	35
c. Sektori i pylltarisë	37

10. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT	38
a. Sektori i urbanizmit	38
b. Sektori i planifikimit	38
c. Sektori i ndërtimit	39
d. Sektori i mbrojtjes së mjedisit	40
e. Sektori i legalizimit	41
11. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE	41
a. Vëllimi financiar dhe fizik i projekteve të realizuara	41
b. Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese	41
c. Hartimi i projekteve për ofertim	42
d. Projektet infrastrukturorë gjatë vitit 2011	43
e. Projektet infrastrukturorë të vitit 2010 të përfunduara në vitin 2011	44
f. Krugët e përcjella në vitin 2012 për shkak të pengesave të ndryshme	45
g. Shqyrtimi i kërkesave	46
12. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM	46
a. Sektori i Shërbimeve Publike	46
b. Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit	47
c. Bashkëpunimi dhe donacionet	49
13. DREJTORIA E KADASTRIT	50
14. DREJTORIA E INSPEKSIONIT	52
a. Sektori Komunal dhe i Komunikacionit	52
b. Sektori i inspektionit të ndërtimit	52
c. Sektori i Inspektionit Komunal dhe të Komunikacionit	53
d. Inspekcioni sanitar dhe veterinar	53
e. Sektori i Tregut dhe Bujqësisë	54

Tabelat

Tabela 1: Pasqyra e të punësuarve në komunë (2011)	15
Tabela 2: Lëndët e pranuar përmes intranetit sipas drejtorive për vitin 2011	18
Tabela 3: Raporti i shërbimeve shëndetësore në QMF për vitin 2011	19
Tabela 4: Raporti i shërbimeve shëndetësore të QMU për vitin 2011	20
Tabela 5: Numri i familjeve në asistencë sociale sipas QPS dhe muajve për vitin 2011	22
Tabela 6: Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake në 2011	31
Tabela 7: Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2011	32
Tabela 8: Konsumi buxhetor sipas programeve krahasuar me buxhetin (%)	32
Tabela 9: Projektet, subvencionet dhe aktivitetet e realizuara	36
Tabela 10: Sipërfaqet e mbjella me kultura pranverore	36
Tabela 11: Kërkesat e pranuar dhe trajtimi i tyre gjatë vitit 2011	38
Tabela 12: Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese për zonën urbane	41
Tabela 13: Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese për zonën rurale	42
Tabela 14: Projektet të kontraktuara për vitin 2011	43
Tabela 15: Projektet e bartura nga 2010 që janë kryer gjatë vitit 2011	44
Tabela 16: Projektet e bartura për vitin 2012 për shkak të problemeve pronësore	45
Tabela 17: Statistikat për intervenimet nga zjarrfikësit gjatë vitit 2011	49
Tabela 18: Tabela e lëndëve për vitin 2011	52
Tabela 19: Paraqitja e lëndëve të Inspektionit Komunal dhe të Komunikacionit	53
Tabela 20: Paraqitja e raportit të sektorit Sanitar dhe Veterinar	54
Tabela 21: Paraqitja e raportit të lëndëve të sektorit tregut dhe bujqësisë	54

1. PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE GJATË VITIT 2011

Ky raport paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2011 nga Kryetari i Komunës dhe qeveria lokale e udhëhequr nga ai. Raporti është në përputhje me kërkesat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për raportim vjetor të Kryetarit të Komunës në Kuvend Komunal. Raporti përmban informata për punën e të gjitha drejtorive dhe zyrave në kuadër të komunës. Raporti përmban edhe disa informata për punën e ndërmarrjeve publike komunale në ofrimin e shërbimeve për qytetarë, por informata më detale për këto ndërmarrje jepen në raportimin e tyre vjetor para Kuvendit Komunal.

a. Buxheti

Në përgjithësi, vitit 2011 ka qenë vit i sfidave për qeverisjen lokale. Vonesat në miratimin e buxhetit të Republikës së Kosovës deri në muajin mars dhe disbursimi i atij buxheti në komunë në muajin prill dhe maj ka bërë që shumë projekte të shtyhen për pjesën e dytë të vitit dhe disa prej tyre të mos realizohen plotësisht. Si rezultat i kësaj dhe i disa problemeve pronësore në disa projekte infrastrukturore, Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2011 ka arritur të shpenzoj 80.02% të buxhetit të planifikuar për këtë vit prej 59,687,719 €.

Si asnjë komunë tjetër në Kosovë si dhe në nivelin qendror, pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale në shpenzimet e tërësishme prej 52% është mjaft e volitshme dhe është indikacion i shpenzimit adekuat të buxhetit në të mirë të përmirësimit të shërbimeve për qytetarë. Komuna po punon ngushtë edhe me disa donatorë në investime kapitale në shkolla, ujësjellës, ngrohje etj. Në përmirësimin e ujësjellësit, komuna po investon 5 milion euro, së bashku me Bankën Gjermane për Zhvillimi (KfW) në projektin madhor të ndërtimit të fabrikës së re të ujësjellësit dhe modernizimin e rrjetit të ujësjellësit, i cili projekt vlerësohet në 35 milion euro dhe pritet të vazhdojë edhe për dy vitet e ardhshme. Komuna po ashtu ka ndarë 2 milion euro për projektin e kogjenerimit të ngrohjes së Termokosit, i përkrahur edhe nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW), Komisioni Evropian me një shumë totale të vlerësuar prej 41 milion euro. Ky projekt tash ka filluar të implementohet, pasi janë nënshkruar marrëveshjet për financim dhe hua, është shpallur tenderi nga ana e KfW-së për konsulentë teknike, e cila do të përgatisë dokumentet e nevojshme teknike për investime. Projekti pritet të kompletohet për dy vitet e ardhshme. Po ashtu, UDAID, SWISSCONTACT dhe Banka Botërore ka mbështetur komunën në ndërtimin e disa shkollave dhe anekseve shkollore.

Komuna e Prishtinës vazhdon të ketë raport të volitshëm të pjesëmarrjes së të hyrave vetanake në buxhetin total të komunës prej 34%, apo 20,175,922 € nga gjithsej buxheti komunal prej 59,687,719 €. Kjo përqindje e të hyrave vetanake në buxhetin total është mjaft e lartë kur kihet parasysh se komunat janë zhveshur nga niveli qendror nga çfarëdo tatimit që mund të mbledhin. I vetmi tatim që tani komunat mbledhin është tatimi në pronën e paluajtshme, derisa të hyrat e tjera janë taksa që reflektojnë vetëm koston e shërbimit që komuna ofron për qytetarë. Taksa tilla janë edhe të hyrat nga lejet e ndërtimit, të cilat megjithatë nuk mjaftojnë për të ofruar infrastrukturën e plotë publike për ndërtimet e reja sidomos në lagjet e pa-urbanizuara plotësisht.

Komuna ka arritur të inkasoi 94% të të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2011. Të hyrat nga lejet e ndërtimit (48% e të hyrave të përgjithshme vetanake) dhe të hyrat nga tatimi në pronën e paluajtshme (20.6%) vazhdojnë të mbeten burime kryesore të të hyrave vetanake

të komunës. Komuna po punon intenzivisht në ngritjen e kapaciteteve për rritjen e inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë, pasi të hyrat nga lejet e ndërtimit kanë tendencë të rënies në të ardhmen për shkak të rënie së trendit të ndërtimeve të reja. Për komunën është shqetësues fakti se qeveria qëndrore po bënë përgatitjet e nevojshme ligjore për rritjen e pragut të poshtëm të tatimit në pronë nga 0.05% në 0.15%. Kjo do të ndikoi në komunë sidomos tek familjet, për të cilat tatimi në pronë në bazë të rregullores komunale në fuqi është 0.11% për familje dhe 0.13% për biznese prodhuese. Në mungesë të Ligjit për Prishtinën, i cili nuk po procedohet tash e tri vite nga qeveria për qëllime politike, Komuna e Prishtinës ka humbur afërsisht 30 milion € (varësisht nga ajo se çfarë përqindje e grantit total të komunave i ndahet Komunës së Prishtinës si grant shtesë për kryeqytetin).

Në mungesë të bazës ligjore për diversifikimin e të hyrave vetanake të komunës, Komuna e Prishtinës do të përballet me vështirësi edhe në të ardhmen për sigurimin e buxhetit të mjaftueshëm për projektet e mëdha kapitale, siç janë unazat e qytetit, modernizimi i trafikut urban, qendrat e mëdha rekreative-sportive etj.

b. Promovimi i zhvillimit ekonomik

Si aktivitet i rëndësishëm që lidhet me zhvillimin ekonomik ka qenë bashkëpunimi me institucione financiare vendore dhe ndërkombëtare për të promovuar zhvillimin ekonomik. Kryetari i Komunës ka mbajtur 19 takime me biznese dhe investitor lokale dhe ndërkombëtare për të promovuar mundësitë që ofron komuna. Po ashtu, Kryetari ose zyrtarët tjerë komunal përgjegjës për zhvillimin ekonomik në komunë kanë marrë pjesë në 35 aktivitete të tjera (si tryeza, konferenca, diskutime etj.) me investitor ndërkombëtar dhe vendor.

Komuna ka punuar ngushtë me Agjencionin për Zhvillim Rajonal Qendër (AZHR-Qendër) në përgatitjen e “Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2011-2014”, e cila është promovuar në një takim të organizuar në muajin tetor nga komuna dhe AZHR-Qendër. Kjo strategji pritet të përdoret për përgatitjet e projekt-propozimeve për investime nga donatorë të ndryshëm, sidomos nga fondet e Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA) të Komisionit Evropian. Komuna ka pasur një numër të takimeve me Odën Ekonomike të Kosovës dhe asociacione të tjera të biznesit për të adresuar problemet dhe shqetësimet e tyre, sidomos sa i përket marrjes së lejeve ndërtimore. Në mbështetje të Komisionit Evropian është hapur zyra ‘One-Stop-Shop’ në komunë, e cila po ofron shërbime dhe informata të nevojshme për biznese dhe qytetarë të interesuar për të bërë biznes në Komunën e Prishtinës. Megjithatë, mungesa e bartjes së regjistrimit të bizneseve nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në komunë e ka kufizuar kapacitetin e kësaj zyre. Kjo gjë po e pamundëson që të ofrojmë të dhëna më detale për numrin e bizneseve që operojnë në Prishtinë dhe numrin e të punësuarve të tyre.

Me ligjin e ri për tregti të brendshme, janë hequr lejet e punës që komuna ka lëshuar për bizneset që operojnë në Komunën e Prishtinës. Ky aktivitet ka sjell një të ardhur prej rreth 750,000 € për komunën, në ndërkohë që ngarkesa për biznese ka qenë simbolike. Përmes këtyre lejeve të punës ka qenë e mundur që të sigurohet një shpërndarje më optimale e bizneseve në lagje të ndryshme të qytetit dhe të kontrollohen kushtet teknike të operimit të bizneseve. Heqja e lejes së punës, mos transferi i regjistrimit të bizneseve nga MTI në komunë si dhe transferimi i inspektionit të tregut nga komuna në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë e ka zhveshur komunën nga çfarëdo kompetence në lidhje me promovimin e zhvillimit ekonomik në komunë. Ne e kemi bërë të qartë në vazhdimësi se ky centralizim kompetencash është në kundërshtim me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Komuna ka mbështetur trajnimin e 30 të rinjve për ndërmarrësi duke i vendosur ata për 6 muaj në punë praktike nëpër biznese të ndryshme si dhe ka përkrahur financiarisht biznes planet e tyre. Komuna ka shpenzuar 23,400 € në projekte për zvogëlimin e papunësisë. Në sektorin e zhvillimit rural janë shpenzuar 427,164 € në përkrahje të bujqve në mbjellje pranverore dhe vjeshtore, në financimin e serave, në furnizimin me fidane, plehra etj. Kjo ka ndikuar dukshëm në rritjen e hapësirave të punëshme të tokave bujqësore dhe ka ndikuar në uljen e papunësisë në këto zona.

c. Administrata komunale

Komuna e ka mbyllur vitin 2011 me një staf prej 719 vetash. Gjatë vitit, janë punësuar 29 shërbyes të rinj civil, 15 veta kanë lëshuar punën ose janë larguar, janë pensionuar 13 veta dhe 3 veta kanë vdekur. Për shkak se punëtorët e rinj janë kryesisht me arsim të lartë, prej vitit në vit po përmirësohet niveli arsimor i të punësuarve në administratë. Derisa në vitin 2009, 26% të punëtorëve kanë qenë me fakultet, në vitin 2011 kjo përqindje ka arritur në 32%. Kjo po ndikon në përmirësimin e shërbimeve për qytetarë. Komuna ka investuar në modernizimin e plotë të shërbimeve për qytetarë në kuadër të administratës komunale duke themeluar “Qendrën për Shërbim për Qytetarë”, e cila tani është në funksion me pajisje moderne të teknologjisë informative që kanë shkurtuar në minimum kohën e pritjes për tu pajisur me dokumentacion të ndryshëm. Zyrat që janë hapur para dy vitesh në lagje të ndryshme të Prishtinës janë lidhur në sistemin on-line për lëshimin e dokumentacionit. Komuna ka ende vështirësi sidomos sa i përket lëshimit të dokumentacionit kadastral dhe të dëshmive të tatimit në pronën e paluajtshme, pasi të dyja këto shërbime menaxhohen nga niveli qendror (nga Agjencioni Kadastral i Kosovës dhe nga Ministria e Financave respektivisht). Me gjithë përpjekjet e komunës në rritjen e efikasitetit të punës në këta dy sektorë, palët ende presin më gjatë se sa duhet për shkak se sistemi on-line i procedimit të këtij lloji dokumentacioni menaxhohet nga niveli qendror.

Komuna ka investuar në përmirësimin kushteve të punës për zyrtarë komunal duke modernizuar pajisjet e teknologjisë informative dhe pajisjen me vetura për punë në terren, pasi një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve komunal janë të angazhuar pjesën më të madhe jashtë zyrës së tyre në mbikëqyrje të projekteve, në inspektion etj.

d. Shëndetësia, arsimi dhe kultura

Janë përmirësuar dukshëm shërbimet shëndetësore si rezultat i investimeve të konsiderueshme zgjerimin dhe modernizimin e hapësirës të qendrave të mjekësisë familjare në qytet dhe në fshatra. Ka filluar ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF) IV në rrugën “Bajram Bahtiri” me një sipërfaqe prej 1,220 metra katrorë, janë blerë pajisje laboratorike dhe mjekësore për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe Qendrën e Mjekësisë Urgjente (QMU) dhe një autoambulancë. Në qendrat e mjekësisë familjare janë regjistruar 790,357 vizita mjekësore, ndërsa në qendrën e mjekësisë urgjente 30,287 vizita. Të gjitha këto shërbime janë ofruar nga një staf i kufizuar prej 135 mjekëve të angazhuar në qendrat e mjekësisë familjare dhe 21 mjekëve në qendrën e mjekësisë urgjente. Sipas standardeve, Komuna e Prishtinës duhet të ketë rreth 250 mjekë nga 156 sa ka tani, si dhe stafin asistues të tyre. Komuna po investon vazhdimisht nga buxheti vetanak dhe në bashkëpunim me shumë investitorë të ndryshëm në rritjen e nivelit profesional të stafit mjekësor përmes trajnime të ndryshme dhe publikimeve mjekësore. Sfidë për Prishtinë mbetet mungesa e Spitalit të Qytetit, i cili po shtyhet në mungesë të ligjit për Prishtinën me

të cilin Prishtina do merrte kompetenca shtesë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore sekondare. Ngarkesa tejet e madhe e QKUK-së me pacientë nga mbarë Kosova ka bërë që qytetarët e Prishtinës të kenë qasje më të dobët në shëndetësinë sekondare krahasuar me regjonet e tjera në Kosovë, të cilat të gjitha posedojnë spitalet regjionale.

Në fushën e arsimit, është shtuar dukshëm hapësira për nxënës nga 0.80 metra katrorë për nxënës sa ka qenë në vitin 2008, në 1.5 metra katrorë në vitin 2010 dhe në 1.6 metra katrorë në vitin 2011. Kjo ka mundësuar eliminimin e plotë të ndërrimit të tretë në shkolla fillore të mesme të komunës. Megjithatë, me rreth 54 mijë nxënës në arsimin parauniversitar, klasat janë të tejngarkuara me nxënës, me 25 nxënës për klasë në arsimin fillore (që është për 20% më shumë se sa standardi i lejuar prej 21 nxënës për klasë) dhe me 34 nxënës për klasë në arsimin e mesëm (që është për 62% më shumë se standardi i lejuar për klasë). Institucionet private të arsimit para-universitar po kontribuojnë përmirësimin e cilësisë dhe kushteve në institucionet arsimore në komunë duke absorbuar rreth 6% të nxënësve në nivel komune. Gjatë vitit 2011, janë lëshuar në punë: dy objekte shkollore të reja me mbi 8,000 metra katrorë, dy anekse të ndryshme të shkollave me 5,500 metra katrorë, një aneks në një institucion parashkollor me 400 metra katrorë, katër terrene sportive në shkolla të ndryshme me rreth 6,000 metra katrorë, janë rregulluar rrethojat dhe oborret në 6 shkolla të ndryshme. Po ashtu, kanë filluar punimet në ndërtimin e gjashtë shkollave të ndryshme dhe një aneksi të shkollës që do e rrisin hapësirën arsimore për rreth 30,000 metra katrorë, dy salla të edukatës fizike, një renovim i një shkolle dhe rregullime të oborreve dhe terreneve sportive të gjashtë shkollave. Shpërndarja e padrejtë e buxhetit për investime në arsim nga ana e MASHT-it po pamundëson që të arrihen standardet e nevojshme në ofrimin e hapësirës mësimore. Komuna e Prishtinës vazhdimisht është e diskriminuar në ndarjet buxhetore për ndërtimin e shkollave fillore e të mesme që MASHT po i ndërton në komuna në kundërshtim me ligjin për arsim komunal. Ky ligj e definon qartë se buxheti për ndërtimin e shkollave duhet tu alokohet komunave sipas nevojave të tyre, e jo shkollat të ndërtohen drejtpërdrejt nga MASHT pa ndonjë analizë paraprakë të nevojave aktuale dhe afatgjate për hapësirë shkollore. Si rezultat, derisa në Prishtinë numri i nxënësve për klasë arrin në 34, në shumë komuna shkollat e ndërtuara para dy-tri viteve po mbyllën në mungesë të nxënësve.

Në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit janë investuar 2.3 milion euro, duke përmirësuar kështu infrastrukturën për aktivitete kulturore dhe rinore-sportive në kryeqytet. Është në përfundim Biblioteka e Qytetit, është rinovuar Teatri Dodona, është furnizuar me inventar Qendra e Kulturore e Fëmijëve, është rinovuar Xhamia e Qarshisë, janë ndërtuar terrene sportive në lagje të ndryshme, ka përfunduar faza e parë e projektit për varrezat e dëshmorëve, është investuar në Hamamin e Qytetit etj. Komuna ka përkrahur artistët, sportistët dhe talentet e rinj në veprimtarinë e tyre artistike, rinore dhe sportive duke financuar projekte të ndryshme në vlerë prej 245 mijë €. Si rezultat i kësaj, janë botuar 88 vepra të ndryshme, janë përkrahur shumë veprimtari teatrore, rreth 40 projekte kulturore, rreth 100 klube sportive, sportistë dhe organizata rinore etj. Komuna ka ngritur efikasitetin e punës së institucioneve kulturore që janë në kuadër të komunës përmes një planifikimi më të mirë të punës së tyre.

e. Infrastruktura dhe urbanizmi

Në fushën e infrastrukturës lokale komuna ka investuar pjesën më të madhe të buxhetit të saj. Gjatë vitit 2011, rreth 20 milion € kanë qenë të dedikuara për investime në këtë fushë për shkak të nevojave të shumta që ka komuna për rrugë, kanalizime dhe ndriçim të standardit ndërkombëtare, sidomos rrugët unazore që ndikojnë në lehtësimin e qarkullimit në qytet dhe

qarkullimit rajonal përmes Prishtinës. Në vitin 2011, janë ndërtuar rreth 90 km gjatësi të rrugëve, rreth 215 mijë metra katrorë trotuare të ndryshme, rreth 52 km gjatësi kanalizime të ndryshme dhe rreth 13 km gjatësi të ujësjellësit. Të gjitha këto kanë përmirësuar dukshëm jetën e qytetarëve, por nevojat ende mesin të mëdha dhe, si rezultat, komuna do të vazhdojë investime madhore në infrastrukturë edhe në vitin 2012. Një numër i projekteve nuk janë realizuar për shkak të problemeve pronësore dhe vonesave në Ministrinë e Financave në procedimin e lëndëve për shpronësim. Këto projekte janë bartur në vitin 2012.

Në fushën e urbanizmit janë trajtuar mbi 1,500 kërkesa të ndryshme dhe janë arkëtuar afër 9 milion € nga taksat për lejet ndërtimore. Janë lëshuar 91 leje të ndërtimit në lagje të ndryshme të qytetit, si dhe 241 leje urbanistike, përfshirë 30 leje të legalizimit dhe 180 raste të tjera të legalizimit janë caktuar kushtet urbanistiko-teknike. Janë mbajtur shumë diskutime me qytetarë dhe palë të interesuara gjatë procesit të përgatitjes së planeve rregulluese për lagje të ndryshme. Janë miratuar 2 plane rregulluese (për lagjet Qamëria dhe Pejtoni) dhe 2 plane rregulluese janë në procedurë duke u përgatitur (për lagjet vellusha dhe Zona Ekonomike) dhe pritet të miratohen në fillim të vitit 2012. Plani i Zonës Ekonomike edhe pse i përfunduar në masën më të madhe ka mbetur që të finalizohet pas definimit të trasesë së autostradës Merdar-Morinë. Disa plane rregulluese janë tenderuar, por në mungesë të ofertave të kualifikuara është dashur të përsëriten dhe të barten për vitin 2012.

f. Ndërmarrjet publike komunale

Ndërmarrjet publike komunale kanë raportuar para Kuvendit Komunal në tremujorin e parë të vitit 2011. Në bazë të raporteve të tyre vjetore, disa prej këtyre ndërmarrjeve po përballen me vështirësi në funksionimin e tyre dhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

Në ndërmarrjen Termokos, është zgjedhur Bordi dhe Kryeshefi Ekzekutiv. Është nënshkruar marrëveshja me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe Ministrinë e Financave për projektin e ko-gjenerimit për ngrohje të qytetit nga avulli i KEK-ut. Në këtë projekt, komuna do të participoi me 2 milion € si dhe do të garantoj për investimet që KfW do të bëjë në Termokos. Projekti pritet të zgjasë dy vite dhe pas implementimit pritet të përgjysmohet kostoja e grohjes për qytetarë si dhe do mundësohet zgjerimi i rrjetit në shumë pjesë të tjera të qytetit. Për shkak të inkasimit të ulët, komuna ka përkrahur Termokosin me subvencione për të mundësuar fillimin e sezonit të ngrohjes dhe për të mbajtur këtë kompani operative, që ka qenë edhe kusht për financim nga ana e KfW.

Kompania “Trafiku Urban” po përballen me vështirësi në sigurimin e të hyrave të nevojshme për të bërë investime të mëdha kapitale në zëvendësimin e autobusëve, të cilët janë të stërvjetëruar dhe nuk i plotësojnë kushtet minimale për operim. Për shkak të grevave të punëtorëve në atë ndërmarrje, ka dhënë dorëheqje kryeshefi ekzekutiv i mëparshëm është zgjedhur kryeshefi i ri nga ana e bordit. Komuna ka angazhuar një ekip të ekspertëve të USAID-it për të përgatitur një projekt fizibiliteti se si të procedohet më tutje me këtë kompani. Komuna po ashtu ka aplikuar në JIKA (Agiencioni i Qeverisë Japoneze për Zhvillim Ndërkombëtar) për furnizim të autobusëve të rinj. Ky donacion pritet të arrijë vitin e ardhshëm nëse kërkesa e komunës miratohet përfundimisht, pas miratimit në parim që ka marrë nga zyrat e JICA-së në Prishtinë.

Kompania “Pastrimi” është pajisur me disa kamionë dhe kontejnerë të rinj të financuar edhe nga GIZ-i gjerman. Kompania ka rritur efikasitetin e funksionimit të saj sa i përket mbledhjes së mbeturinave urbane. Mbështetur nga GIZ-i, është përgatitur strategjia

komunale për mbledhjen e mbeturinave, e cila parasheh disa masa të rëndësishme në mbledhjen dhe trajtimin e mbeturinave drejt arritjes së standardeve ndërkombëtare. Kompania po përballlet me inkasim të ulët nga ana e qytetarëve, megjithëse çmimi për mbeturina nuk është i lartë. Projektligji i ri për ujë dhe mbeturina që është proceduar në Kuvendin e Kosovës nuk pritet që do të definojë dhe fuqizoi kompetencat e komunës në lidhje me menaxhimin e mbeturinave urbane, edhe pse kjo çështje sipas të gjitha përvojave ndërkombëtare duhet t'i takoi pushtetit lokal. Kështu, komuna ka vështirësi në ndërmarrjen e masave sa i përket tarifave, financimit si dhe masat për depozitë e mbeturinave.

Komuna e Prishtinës ka përkrahur projektin e ndërtimit të fabrikës së re të ujit me një buxhet prej 5 milion euro. Komuna ka punuar ngushtë me kompaninë e Ujësjetllësit Rajonal Prishtina për të kryer procedurat e shpronësimit për gypin e ujësjetllësit për fabrikën e ujit në Shkabaj.

g. Qeverisja komunale dhe bashkëpunimi ndërinstytucional

Me qëllim të koordinimit të punës dhe rritjes së efikasitetit të institucioneve komunale, kryetari dhe ekipi tij kanë mbajtur 165 aktivitete/takime me zyrtarë komunal, 17 vizita në terren për inspektimin e punimeve infrastrukturore, rreth 54 takime koordinimi me grupe punuese, këshillin e drejtorëve, kuvendin komunal, komitetet e kuvendit etj. Po ashtu, janë mbajtur 75 takime me qëllim bashkëpunimi dhe koordinimi me institucione, organizata, ndërmarrje publike dhe administratë publike (lokale, rajonale dhe qendrore). Janë mbajtur 18 takime me përfaqësues të partive politike të nivelit lokal dhe qendror, 27 takime me institucionet qendrore, 12 takime dhe aktivitete jashtë zyrës së kryetarit me qëllim të përfaqësimit të interesit të komunës etj. Kryetari ka marrë pjesë në 22 raste të ceremonive zyrtare vendore dhe ndërkombëtare të natyrës ceremoniale dhe përkujtimore.

Me gjithë vullnetin e qeverisë komunale për bashkëpunim, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka arritur që obligimet e veta kushtetuese në raport me Komunën e Prishtinës t'i plotësoj. Si rezultat i kësaj, ka ngecur ligji për kryeqytetin dhe kjo ka pamundësuar krijimin e një baze më të mirë buxhetore për Komunën e Prishtinës dhe të një kapaciteti institucional ligjor më të lartë. Komuna ka bashkëpunuar me ministritë e linjës në realizimin e disa projekteve kapitale.

h. Transparenca, komunikimi dhe përfshirja e qytetarëve në qeverisje:

Komunikimi me qytetarë dhe informimi për shpenzimin e buxhetit dhe investimet kapitale në fusha të ndryshme gjatë vitit 2011 ka qenë prioritet i Kryetarit të Komunës. Për realizimin e këtij objektivi programor janë ndërmarr një seri aktivitete dhe politikash:

- Pjesëmarrje në konferenca dhe seminare me qëllim të prezantimit të punës dhe të realiteteve të komunës në 66 raste,
- Për identifikimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve si dhe të përfshirjes së tyre në qeverisjen e Prishtinës janë mbajtur 65 takime individuale dhe grupore me qytetarë të ndryshëm të komunës,
- Janë organizuar 39 takime me medie (konferenca, takime formale dhe jo formale) ku janë diskutuar, prezantuar punët dhe të arriturat e komunës,
- Me qëllim të identifikimit të mundësive për lehtësimin e punës së gazetarëve janë mbajtur 12 takime individuale me drejtues të medias,

- Shoqëria civile si partner në qeverisje është konsultuar dhe angazhuar nëpërmjet pjesëmarrjes në komisione komunale si dhe në 19 takime në formën e konsultimit direkt,
- Përfaqësues të sindikatave janë konsultuar në takime formale të paktën 6 herë,
- Komuniteti fetar ka qenë i përfshirë në takime dhe konsultime për të trajtuar mundësitë e bashkëpunimit dhe të zgjidhjes së problemeve me të cilat ata përballohen, janë takuar dhe konsultuar në 6 raste.
- Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 17 tubime me qytetarë për çështje të përgjithshme dhe ato specifike. Përveç debateve të rregullta me qytetarë dhe përfaqësues të lagjeve janë mbajtur edhe takime të tjera në të cilat janë shqyrtuar çështjet e statutit, buxhetit etj. Në këtë tubime dhe debate janë trajtuar tema të ndryshme si:
 - Debat i rregullt me qytetarë (1),
 - Debate për ndryshimin e Statutit të Komunës (4),
 - Debate për planet rregulluese të lagjeve Medreseja-Çamëria, Vellusha (5),
 - Debat me Publik me përfaqësues të Biznesit dhe Ekspertët e Ekonomisë, shtator-dhjetor (2),
 - Debat për planifikimin e buxhetit për vitin 2012 në disa lagje të qytetit (4),
 - Takim me qytetar për trashëgiminë kulturore- historike të qytetit (1).

Përveç këtyre takimeve, kryetari i komunës, gjatë periudhës raportues ka pritur në 44 raste në takime të ndryshme grupe të qytetarëve, përfaqësues të lagjeve dhe takime individuale me qytetarë. Në të gjitha debatet, numri i qytetarëve dhe i palëve të interesit ka qenë i kënaqshëm dhe ndikimi i qytetarëve nga këto debate ka qenë evident. Si rezultat, këto debate kanë ndihmuar udhëheqjen e komunës dhe propozimet, idetë dhe sugjerimet e dala nga debatet janë marrë seriozisht. Zyra e kryetarit ka pranuar rreth 940 raste/kërkesa, të gjitha rastet janë dërguar te organet kompetente për procedim adekuat.

i. Siguria publike

Prishtina në vitet e fundit karakterizohet me një gjendje stabile të sigurisë. Ky segment i jetës dhe mirëqenies sociale të qytetarëve është trajtuar me kujdes të veçantë dhe janë arritur suksese të mira. Kryetari ka qene i përfshire në rreth 60 aktivitete, koordinime dhe konsultime me organet e sigurisë. Në 11 raste kryetari ka pritur në takim përfaqësuesit me të lartë të KFOR-it, PK, FSK-se dhe EULEX-it. Është siguruar koordinim shumë i mirë me organet e sigurisë për rrënimin e ndërtimeve pa leje.

j. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Viti 2011 ka shënuar një rritje të bashkëpunimit ndërinstitucional në mes të kryeqytetit të Republikës së Kosovës dhe kryeqyteteve të ndryshme të Evropës dhe botës. Me qëllim të avancimit të bashkëpunimit dhe të promovimit të zhvillimit dhe të investimeve janë mbajtur 44 takime dhe aktivitete me përfaqësues të ambasadave të vendeve të BE-së, SHBA-së dhe Turqisë. Kryetari i komunës gjatë këtij viti ka realizuar 10 vizita jashtë vendit. Kryetari i Komunës ka arritur që të ketë bashkëpunim të kënaqshëm me partner të rëndësishëm ndërkombëtar. Ky bashkëpunim është zhvilluar dhe avancuar duke u materializuar me vizita shumë të rëndësishme si në SHBA Turqi, Francë, Belgjikë, Zvicër, Greqi, e shumë vende të tjera, si dhe vizita të partnerëve ndërkombëtar në Komunën e Prishtinës. Këto vizita janë bërë në vazhdim të bashkëpunimit me Asociacionin e Komunave të Kosovës, po ashtu edhe në bashkëpunimin që Komuna e Prishtinës ka me komuna të veçanta nga vende të tjera.

Takime me përfaqësues të BE-se, ICO, EULEX-it Bankës Botërore, FMN-së, Komisionit Evropian, USAID, Swisscontact etj, janë realizuar në 19 raste.

2. MBLEDHJET E KUVENDIT, EKZEKUTIVIT DHE TRUPAVE PUNUESE

Mbledhjet e të gjitha trupave komunale janë mbështetur dhe organizuar nga sektori për kuvend. Ky sektor ka kryer punë profesionale dhe administrative në përgatitjen e materialeve (rregulloret, vendimet etj.) për mbledhje, ka bashkëpunuar me drejtoritë komunale në hartimin e rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme, ka kryer konsultime gjatë miratimit të rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme, ka përcjell zbatimin e vendimeve dhe rregulloreve të miratuara në Kuvend, ka bërë përkthime, lektorime dhe shpërndarje të materialeve, hartimin e ekstrakteve të mbledhjeve etj.

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur:

- 23 mbledhje të rregullta të Këshillit të Drejtorëve,
- 12 mbledhje të Kuvendit të Komunës,
- 12 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa,
- 12 mbledhje të Komitetit për Komunitete,
- 6 mbledhje të Komitetit për Planifikim, Urbanizëm dhe Ndërtim,
- 3 mbledhje të Komitetit për Shëndetësi, Mirëqenie Sociale dhe Strehim,
- 6 mbledhje të Komitetit për Arsim, Kulturë dhe Sport,
- 3 mbledhje të Komitetit për Shërbime Publike,
- 3 mbledhje të Komitetit për Pronë,
- 9 mbledhje të Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive,
- 17 mbledhje-tubime me qytetarë (takime të rregullta, takime për përgatitjen e buxhetit, për plane rregulluese, për statutin e komunës, për ndryshime kushtetuese etj.),
- 19 mbledhje të komisionit për emërtimin e rrugëve.

Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka miratuar: 5 rregullore, 2 raporte (raportin vjetor për vitin 2010 dhe raportin 6 mujor për vitin 2011), 7 statute të ndryshme të institucioneve komunale dhe ka marrë 37 vendime të ndryshme.

3. AKTIVITETET E ZYRAVE

a. Zyra e përfaqësimit juridik

Zyra e përfaqësimit juridik ushtron mjetet për mbrojtje juridike të të drejtave dhe të interesave të komunës. Gjatë periudhës raportuese, janë trajtuar 393 lëndë, prej të cilave 70 janë të bartura nga vitet paraprake. Për të gjitha këto lëndë, komuna është përfaqësuar në 429 seanca gjyqësore. Janë ushtruar 44 ankesa, 2 revizione, 12 kundërshtime, 12 padi, 8 kallëzime penale, 284 përgjigjeje në padi, 1 përgjigje në propozim, 1 kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, 17 njoftime, dhe 210 kërkesa për shënime dhe 62 të ndryshme. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kanë arritur 136 aktgjykime, 188 aktvendime, 15 ankesa, 1 revizione, 5 parashtrës, 3 ekspertiza, 128 padi, 2 propozime për ekzekutim dhe 501 të ndryshme. Për nga natyra e kontesteve, lëndë civile-pronësore janë 91, konteste pune 170, konteste administrative 111, procedura penale 20, jokontestimore 1. Duke u nisur nga numri i gjithmbarshëm i lëndëve në procedurë dhe mënyrën e zhvillimit të procedurës gjatë periudhës raportuese kanë përfunduar si lëndë të kryera 89. Lidhur me lëndët të cilat janë

në procedure e sipër, janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme duke ushtruar mjete të rregullta juridike si dhe mjete të jashtëzakonshme juridike.

b. Zyra për auditim të brendshëm

Gjatë kësaj periudhe, janë zhvilluar disa aktivitete të auditimit dhe shërbime për këshillime për organet e komunës. Njësia e auditimit të brendshëm gjatë vitit 2011 ka përfunduar auditimin e njësisë së transportit, të hyrave të drejtorisë së arsimit për vitin 2009 dhe të hyrave të drejtorisë së kadastrit për vitin 2010. Gjatë muajit dhjetor, ka filluar auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2011. Gjatë vitit 2011, njësia e auditimit ka përpiluar planin strategjik të njësisë së auditimit 2012 – 2014 si dhe plani vjetore të vitit 2012. Gjatë muajve janar-mars, një zyrtar i auditimit ka marrë pjesë në pilot auditimin e prokurimit në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në kuadër të trajnimit “demonstrimi praktik i teorive të mësuara nga seminarët“. Në muajin tetor, zyrtarët e auditimit kanë marrë pjesë në një trajnim të organizuar nga njësia qendrore e auditimit të brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave.

c. Departamenti i Prokurimit

Gjatë vitit 2011, janë zhvilluar 289 aktivitete të prokurimit (në vlerë prej 39,355,609 €), prej tyre janë kontraktuar 248 aktivitete dhe 41 të tjera kanë qenë në procedurë deri më datë 31.12.2011 (të anuluar, të shpallura ose në vlerësim). Mbi 81% e prokurimeve kanë të bëjnë me investime kapitale. Llojet e aktiviteteve të prokurimit të kontraktuara janë si në vijim:

- Punë – projekte kapitale	31,942,204 €	81.16%
- Furnizime me mallra	5,371,278 €	13.65%
- Shërbime dhe projekttime	1,906,787 €	4.85%
- konkurse projektimi	135,340 €	0.34%
Gjithsej	39,355,609 €	100.00%

Mbi 97% e prokurimeve të kontraktuara kanë kaluar përmes procedurës së tenderit publik. Kuotimet me vlera deri në 10,000 € dhe furnizimet me vlera minimale nën 1,000 € marrin pjesë me vetëm 0.96%. Procedurat e aplikuara janë paraqitur në vijim:

- Procedurë e hapur	38,273,034 €	97.25%
- Aprovime nga APP dhe negociimet	704,896 €	1.79%
- Kuotimet	352,646 €	0.90%
- Vlera minimale nën 1000€	25,033 €	0.06%
Gjithsej	39,355,609 €	100.00%

Rreth 50% e punëve, furnizimeve dhe projekteve të kontraktuara kanë qenë me vlerë të madhe dhe gati po aq me vlerë të mesme. Kontratat sipas vlerave janë dhënë në vijim:

- Vlera e madhe	19,466,067 €	49.46%
- Vlera e mesme	19,511,863 €	49.58%
- Kuotime	352,646 €	1.36%
- Vlera min. nën 1000€	25,033 €	0.14%
Gjithsej	39,355,609 €	100.00%

Në vijim janë projektet më të rëndësishme kapitale të kontraktuara gjatë vitit 2011, vlera e secilit prej tyre është afër një milion euro apo më shumë:

- Ndërtimi i rrugës “Ibrahim Fehmiu” në Prishtinë	939,190 €
- Ndërtimi i rrugës “B” faza e dytë ,	2,883,847 €

- Ndërtimi i rrugës “Ahmet Krasniqi”	986,957 €
- Ndërtimi i rrugës “Ekrem Rexha”	771,266 €
- Ndërtimi i rrugës “B”, faza e katërt	1,141,021 €
- Ndërtimi i Sheshit të pavarësisë “Ibrahim Rugova”	4,365,714 €
- Ndërtimi i rrugës “Qemajl Stafa”	870,000 €
- Ndërtimi i shkollës ekonomike në Prishtinë	1,399,486 €

Departamenti i prokurimit në bazë të raporteve zyrtare të organeve mbikëqyrëse dhe komisioneve të pranimit, ju ka shqiptuar dënime operatorëve ekonomik të pa përgjegjshëm për vonesa në kryerjen e punëve dhe ka marrë masa tjera konform ligjit.

d. Zyra për marrëdhënie me publikun,

Zyra për marrëdhënie me publikun çdo ditë kontaktohet dhe kontakton mediat e shkruara dhe elektronike që veprojnë në Prishtinë, si dhe ka raportuar rregullisht për punët dhe aktivitetet e Komunës së Prishtinës. Kjo zyrë bashkëpunon me zyrën për protokoll në kabinetin e kryetarit të Prishtinës. Janë përcjell të gjitha takimet protokollare të kryetarit të komunës, mbledhjet e Kuvendit Komunal, të Këshillit të Drejtorëve, dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa, Këshillit për Siguri në Bashkësi dhe përmes komunikatave për media është informuar opinioni publik. ZMP ka distribuuar për media numër të madh informatash, lajme, ftesa, komunikata, reagime dhe kumtesa për opinion, të cilat janë plasuar edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës. Gjatë vitit 2011 nga ZMP-ja janë organizuar konferenca për media, të cilat janë përcjell nga pothuajse të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara. ZMP ka qenë pjesë e organizimeve të ndryshme si debateve publike, përrurimeve, inaugurimeve dhe promovimeve të ndryshme, punëtorive etj. Kjo zyrë përcjell vazhdimisht shtypin ditor dhe mediat elektronike, dhe ka veçuar tekstet në faqet e gazetave ku shkruhet për komunën e Prishtinës, duke i ruajtur dhe arkivuar ato. Përveç punëve të përditshme, kjo zyrë është përkujdesur edhe për funksionimin e ueb-faqes së Komunës së Prishtinës. Krahasuar me vitin e kaluar, kjo zyrë ka pasur vëllim më të shtuar të punëve të gjitha fushat. ZMP ka punuar në një doracak që pritet të dalë gjatë vitit 2012 mbi projektet e realizuara dhe aktivitetet tjera në Komunën e Prishtinës për vitin 2011.

e. Zyra ligjore

Zyra ligjore ka zhvilluar punën e saj kryesisht bazuar në dhënien e këshillave, informacioneve për ekzekutivin, sektorët – zyrat, institucionet e arsimit dhe të shëndetësisë dhe ndërmarrjet publike komunale si detyrë e përhershme. Shqyrtimin e të gjitha propozimvendimeve dhe rregulloreve, të cilat i janë dërguar zyrës nga ana e drejtorëve të drejtorive, të drejtorëve të institucioneve arsimore, shëndetësore dhe të ndërmarrjeve publike lokale, zbatimin e Ligjit nr. 03/L - 04 për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008): -në hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Prishtinës, të Rregulloreve dhe Vendimeve komunale kompetencë e Kuvendit të Komunës. Po ashtu pjesëmarrje aktive në: Këshillin e Drejtorëve; Komitetet joobligative, Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës, pjesëmarrje në debate publike me qytetar të Komunës së Prishtinës; pjesëmarrje në takime të ndryshme në Shqipëri, Maqedoni dhe në komunat e Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me nivelin komunal. Zyra Ligjore ka bere përpilimin e kontratave për shfrytëzim të tokës – objekteve, në pajtim me vendimet e miratuara në Kuvendin e Komunës, hartimin e vendimeve, urdhëresave nga kompetenca e Kryetarit të Komunës si dhe pjesëmarrje në grupe punuese në nivel të Qeverisë së Kosovës, etj.

f. Zyra Komunale për Integrim Evropian

Zyra Komunale për Integrim Evropian punën e saj e bazon kryesisht në veprimet që dalin nga PVPE-ja dhe kujdeset për zbatimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian në Komunë. Në mars të vitit 2011 është miratuar PVPE dhe që nga ajo kohë është filluar me punët rreth përmbushjes së detyrave që dalin nga ky plan. Në muajin gusht është raportuar për Komisionin Evropian përmes MAPL-së për punën 6 mujore për shumicën e veprimeve që dalin nga PVPE-ja për Komuna. Janë mbajtur takimet e rregullta të ZKIE në kuadër të Kolegjiumit të ZKIE-ve brenda Asociacionit të Komunave të Kosovës, ku përgatitur rregullorja e punës së ZKIE-ve dhe e cila është miratuar në qershor 2011 nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Vlen të përmendet për vitin 2011 bashkëpunimi i ngushtë me ZKKK me qëllim të implementimit të Strategjisë së Qeverisë dhe Planit të veprimit të Qeverisë për personat e riatdhesuar si proces me rëndësi nacionale, ku edhe me vendim të Kryetarit të komunës u formua edhe grupi punues për implementimin e kësaj strategjie. Zyrtarja Komunale për Integrim Evropian ka ndjekur trajnimin treditor të organizuar nga IKAP me temë qasja në fondet IPA-së. Po ashtu, trajnimin treditor të organizuar nga Projekti Perspektiva Evropiane me temë “Zhvillimi i Aftësive Komunikuese”. Pjesëmarrje në përgatitjen e Projekteve për aplikim në fondet EURED, fondet dhe projekt thirrjet e MAPL-së gjithnjë në bashkëpunim të ngushtë me Agjensionin për Zhvillim Rajonal - Qendër. Pjesëmarrja e Zyrtares në takimet e rregullta koordinuese me projektet e fituara nga skema EURED për rajonin ekonomik qendër.

g. Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore

Duke u mbështetur në plan programin e vitit 2011 janë realizuar disa aktivitete duke shfrytëzuar bashkëpunimin e drejtorive përkatëse si dhe organizatat ndërkombëtare dhe atyre vendore. Që nga fundi i vitit 2010, me ndihmën e OSBE, është themeluar grupi jo formal i grave ku në këtë grup bëjnë pjesë këshilltaret e asamblesë komunale dhe shoqëria civile. Në mars 2011 është mbajtur trajnimi me temën “Të Drejtave të Njeriut” ku janë përfshirë të gjitha grup moshat. Me rastin e 22 Prillit (Ditës Ndërkombëtare të Tokës) është mbajtur fushatë vetëdijesimi mbi mbrojtjen e natyrës. Është bashkëpunuar me gratë e komunave të tjera dhe shoqërinë civile në shënimin e aktiviteteve dhe datave të ndryshme. Zyra ka organizuar fushatën e vetëdijesimit “25 Nëntori - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas”. Gjithashtu, zyrtarët kanë marrë pjesë në debate e takime të ndryshme. Gjatë vitit 2011 është zhvilluar aktiviteti “Tetor muaj i mundësive të barabarta profesionale për personat me aftësi të kufizuara”, i mbështetur financiarisht edhe nga komuna. Në bashkëpunim me OSBE-në, në këtë njësi janë pranuar si praktikant 3 persona nga shoqata e të verbërve, që kanë qenë absolventë në Universitetin Prishtinës për 3 ditë radhazi. Janë mbajtur trajnime me komunitetin e ashpërve për rëndësinë e vijimit të arsimit, trajnime për përgatitjen e grave për punësim, dy panairë të grave që janë financuar nga Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Fushë Kosovës, panairi i të rinjve etj.

h. Zyra për kthim dhe komunitete

Gjatë vitit 2011, komunitetet pakicë kanë pasur qasje të mirë në shërbimet publike në të gjitha institucionet komunale. Janë realizuar 6 takime me përfaqësues të OSBE-së ku është diskutuar rreth strategjisë së ri-integrimit të personave të riatdhesuar. Janë mbajtur 4 takime me OJQ Ura që po implementon projektin “Kosova Projekt”. Janë zhvilluar 10 takime me zyrtarë nga UNHCR dhe KAAD lidhur me kërkesat e personave të riatdhesuar për pajisjen e

tyre me dokumentacionin e nevojshëm. Janë mbajtur takime të rregullta me IOM. ZKKK ka marr pjesë rregullisht në 11 takimet e Komitetit për Komunitete, ku janë shqyrtuar plani i punës, vizitat rajoneve me popullatë të komuniteteve pakicë, shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të pjesëtarëve të komuniteteve, gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe sigurisë etj. ZKKK ka bashkëpunuar me ministri të ndryshme në çështje të komuniteteve pakicë në komunë, ku janë diskutuar politikat qeveritare për ri-integrimin e personave të kthyer, mekanizmat institucional për koordinimin e zbatimit të strategjisë për kthim dhe ri-integrim, kriteret për përfitim nga programi për ri-integrim etj. Gjatë vitit 2011, janë regjistruar të zhvendosurit (5 familje të komunitetit ashkali me 25 anëtarë), të cilët janë kthyer në shtëpitë e tyre të ndërtuara nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) dhe UNHCR. Po ashtu, në zyrë janë lajmërua 26 familje me 97 anëtarë (prej tyre 20 familje shqiptare me 71 anëtarë, 1 familje turke me 5 anëtarë, 4 familje rome me 21 anëtarë). Janë integrua 15 familje me 62 anëtarë (prej tyre 13 familje shqiptare me 50 anëtarë, 2 familje rome me 12 anëtarë dhe 7 persona pa familje). Janë realizuar 4 takime të Këshillit Qeveritar për ndihmë dhe përkrahje të kthyerve. Janë organizuar 4 tryeza diskutimi lidhur me integrimin e personave të ri-atdhesuar.

4. DREJTORIA E ADMINISTRATËS

a. Njësia e personelit

Njësia e personelit është angazhuar në kryerjen e punëve konform dispozitave të Ligjit nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2011, në kuadër të shërbimit civil komunal ka pasur lëvizshmëri të shërbyesve civil si vijon:

- Janë larguar nga puna 4 shërbyes civilë,
- Nga zyra e komuniteteve që ka qenë në Graçanicë, 11 shërbyes civil kanë kaluar nga Komuna e Prishtinës në Komunën e Graçanicës,
- Janë pensionuar 13 shërbyes civilë,
- Kanë vdekur 3 shërbyes civilë,
- Kanë themeluar marrëdhënie pune 29 shërbyes civilë.

Komuna ka mbyllur vitit 2011 me gjithsej 719 të punësuar. Prej tyre 230 (32%) me fakultet, 39 (5%) me shkollë të lartë, 431 (60%) me shkollë të mesme dhe 19 (3%) me arsim tjetër. Për nga struktura etnike, 675 (94%) shqiptarë, 33 (5%) serbë, 7 (1%) turq dhe 4 (1%) të tjerë. Për nga struktura gjinore, 482 (67%) janë meshkuj, ndërsa 237 (33) janë femra. Në tabelën në vijim është paraqitur struktura kualifikuese, etnike dhe gjinore e të punësuarve.

Tabela 1: Pasqyra e të punësuarve në komunë (2011)

	Drejtoria	Nr.	Kualifikimet				Struktura etnike				Gjinia	
			Total	Fakultet.	Shkollë e lartë	Shkollë e mesme	Stafi Mëshkulluar	Shqiptarë	Serbë	Turq	Të tjerë	Meshkuj
1	Drejtoria e Administratës	117	13	10	83	11	112	1	3	1	93	24
2	Drejtoria e Inspektionit	50	30	-	20	-	50	-	-	-	37	13
3	Drejtoria e Financave dhe Pronës	78	15	4	58	1	74	4	-	-	45	33
4	Drejtoria e Urb., Nd. dhe Mbr. së Mjed.	43	35	1	7	-	42	-	1	-	15	28
5	Drejtoria e Shën. dhe Mir. Sociale	8	6	-	2	-	8	-	-	-	4	4
6	Drejtoria e Infrastrukturës Lokale	20	8	2	10	-	19	-	-	1	11	9
7	Drejtoria e Arsimit	22	16	1	5	-	20	-	1	1	12	10
8	Drejtoria e Ekonomi dhe Zhvillim	33	15	-	17	1	32	-	1	-	24	9
9	Drejtoria e Kadastrit	31	8	2	21	-	31	-	-	-	18	13

10	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sp.	7	7	-	-	-	7	-	-	-	-	-	7
11	Drejtoria e Shër. Publike dhe Shpë.	32	10	8	14	-	32	-	-	-	-	27	5
12	Zjarrfikësit	115	1	4	110	-	90	25	-	-	-	112	3
13	Zyra për marrëdhënie me publikun	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	1	-
14	Zyra ligjore	3	2	-	1	-	3	-	-	-	-	2	1
15	Zyra e prokurimit	10	7	-	3	-	10	-	-	-	-	7	3
16	Zyra e pranimit – pritëse	10	4	1	5	-	9	-	1	-	-	3	7
17	Zyra për teknologji informative	3	-	-	3	-	2	-	-	-	1	3	-
18	Zyra për kthim	2	1	-	1	-	1	1	-	-	-	1	1
19	Njësia e auditimit të brendshëm	3	3	-	-	-	3	-	-	-	-	2	1
20	Avokatura Publike	2	1	-	1	-	2	-	-	-	-	1	1
21	Nëpunës për komu. dhe çështje gjinore	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1
22	Zyrtare për integritet evropiane	1	1	-	-	-	1	-	-	-	-	-	1
23	Instituti i Monu. dhe Muzeu Rajonal	5	-	-	3	2	5	-	-	-	-	3	2
24	Arkivi i Qytetit të Prishtinës	12	4	-	8	-	12	-	-	-	-	5	7
25	Biblioteka “Hivzi Sylejmani”	35	7	4	22	2	35	-	-	-	-	16	19
26	Qendra e pionierëve	7	4	-	3	-	7	-	-	-	-	3	4
27	Teatri “Dodona”	18	3	-	13	2	18	-	-	-	-	15	3
28	Shtëpia e Kul. Bardhosh dhe Hajvali	2	-	-	2	-	1	1	-	-	-	2	-
29	Qendrat për punë sociale	48	27	2	19	-	47	1	-	-	-	20	28
	Gjithsej	719	230	39	431	19	675	33	7	4	482	237	

b. Sektori i punëve të përgjithshme

Në sektorin e punëve të përgjithshme, janë kryer këto punë dhe aktivitete:

- Është bërë kompletimi i dosjeve të punëtorëve me përgjigjet kthyesë lidhur me vlerësimin e përmbushjes së detyrave dhe punëve për çdo punëtor për vitin 2010 dhe plani i punës për vitin 2011,
- Janë përcjell afatet e skadimit të kontratave të punës,
- Gjatë muajit maj është punuar në mbledhjen e të dhënave përmes pyetësorit për lëshimin e vendimeve për pushim vjetor gjatë vitit 2011,
- Janë kryer punët administrative lidhur me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për pensionimin e punëtorëve që kanë mbushur moshën e pensionimit,
- Është bërë kompletimi i dosjeve të punëtorëve,
- Janë kryer punët lidhur me shpalljen e konkurseve,
- Është bërë përcjellja e lëndëve-kërkesave të ndryshme të punëtorëve, dërgimi i shkresës unike për të gjitha drejtoritë për identifikimin e nevojës për trajnim të shërbyesve civilë nga fusha e veprimtarisë së drejtorisë përkatëse,
- Lëshimi i vërtetimeve për nevojat e punëtorëve, etj.

Në kuadër të arkivës pasive, është bërë klasifikimi i lëndëve të Kuvendit Komunal, renditja e dokumentacionit të tenderëve dhe ofertave të ndryshme të zyrës së prokurimit, nga shërbimi i ofiçarisë janë dorëzuar një numër i madh i kërkesave të ndryshme etj. Për shkak të kushteve të vështira të punës në arkivë, është bërë kërkesë për adaptimin e lokalit të arkivës. Shërbimi i byroteknikës ka kryer punë nga fushëveprimi i vet që përbëhet në fotokopjimin, shumëzimin dhe rregullimin e materialit për nevojat e të gjitha drejtorive. Në total janë shumëzuar 310,000 kopje të ndryshme.

c. Sektori i bashkësive lokale

Gjatë periudhës raportuese, ky sektor nëpërmjet bashkësive lokale ka organizuar bashkëpunimin më të mirë të komunës me qytetarët në identifikimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme kryesisht nga lëmi i infrastrukturës. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë organizuar tubime me qytetarë në disa bashkësi lokale lidhur me nevojat e tyre si dhe

tubime me qytetarë për përgatitjen e buxhetit për projekte kapitale për vitin 2012. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe raportuese janë përgatitur dhe mbajtur zgjedhjet për këshilla dhe për kryetarë të këshillave në 33 Bashkësi Lokale, në tërë territorin e Komunës së Prishtinës. Zyrat e bashkësive lokale kanë kryer shërbime administrative të ndryshme, ku sipas kërkesave të palëve janë lëshuar gjithsej 19,250 vërtetime për rregullimin e dokumentacionit personal, të drejtave në asistencë sociale, të drejtave të qytetarëve që përkohësisht jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme etj.

d. Sektori teknik

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto punë dhe detyra:

- Është bërë fasadimi i objektit të vjetër të Komunës, punimi dhe montimi i rrufepritisit në kulmin e objektit të komunës,
- Janë punuar shkallët emergjente në dy vende të objektit të komunës,
- Është bërë renovimi i sallës së madhe të Kuvendit Komunal,
- Është bërë hidroizolimi i kulmit të sallës së Kuvendit Komunal,
- Është bërë renovimi i hyrjeve, sporteleve dhe shkallëve në objektin e komunës,
- Është bërë sigurimi dhe mirëmbajtja e objekteve të komunës, përfshirë këtu edhe sigurimin shtesë nga ana e policisë së Kosovës,
- Është bërë mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe e rrjetit telefonik brenda objekteve të komunës dhe aktivizimi i 5 lidhjeve telefonike në objektin e ri të Komunës dhe
- Është bërë renovimi, ngjyrosja dhe rregullimi i disa zyrave brenda objektit të Komunës.

Gjatë periudhës raportuese, nga gjithsej 70 automjete, gjatë kryerjes së punëve zyrtare janë shënuar 559,591 km. Sa i përket shpenzimeve të karburanteve, nga automjetet e Komunës janë harxhuar 75,852 litra karburant.

e. Sektori i gjendjes civile

Në sektorin e gjendjes civile, janë regjistruar 10,670 fëmijë të porsalindur, prej tyre 5,541 janë të gjinisë mashkullore dhe 5059 të asaj femërore. Janë lëshuar 117,364 certifikata të lindjes, 15,092 certifikata të martesës, 7,859 certifikata të vdekjes, 1,431 certifikata të vendbanimit, 36,632 certifikata të shtetësisë, 4,978 certifikata të statusit martesor, 745 certifikata jete dhe 9,882 certifikata të bashkësisë familjare. Janë realizuar 1,333 kurorëzime dhe 2,348 regjistrime të reja në LTHV. Janë bërë shumë regjistrime të lindjeve, martesave dhe të vdekjeve për qytetaret tanë të cilat kanë ndodhur në jashtë vendit e cila në shifra duket si vijon: në LTHL-janë regjistruar 2,028 lindje, në LTHM janë regjistruar 321 kurorëzime, dhe në LTHV janë regjistruar 68 raste të vdekjes.

Në shërbimin e përshkrimeve dhe vërtetimeve gjatë periudhës raportuese janë vërtetuara 47,946 lëndë dhe 143 deklarata me dy dëshmitar. Ndërsa sa i përket reregjistrimeve gjatë kësaj periudhe ka ekzistuar gjendja si vijon: ri-regjistrime në LTHL 4,586, ri-regjistrime në LTHM 386, dhe ri-regjistrime në LTHV 195.

Gjatë periudhës raportuese në sektorin e gjendjes civile janë lëshuar 325 dëshmi vdekje. Janë lëshuar 242,072 dokumentacione të ndryshme që hynë në domenin e punëve të këtij sektori. Janë lëshuar edhe 2,040 aktvendime të ndryshme për: ndërrimin e emrit-mbiemrit (personal-familjar) 133, për korrigjimin e emrit-mbiemrit (personal-familjar) 611, për korrigjimin e të

dhënave të tjera në LTHL, LTHM, LTHSH, LTHV 489, për regjistrim të mëvonshëm në LTHL 766, për regjistrim të më vonshëm në LTHV 15, për refuzim të kërkesave 7, për anulimin e regjistrimeve të dyfishta në LTHL 4, dhe kërkesa të hedhura poshtë për mos kompletim të lëndës 15.

f. Qendra e shërbimit për qytetar

Gjatë vitit 2011, është funksionalizuar qendra e shërbimit për qytetarë në bazë të urdhëresës administrative përkatëse të lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Në bazë të raportit të lëndëve të pranuar në intranet, gjatë vitit 2011 janë evidentuar 22,148 lëndë të pranuar. Prej këtyre lëndëve, vetëm 9% kanë mbetur të pakryera, të cilat kryesisht janë lënë që kanë arritur në fund të vitit 2011. Po ashtu, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë një numër i lëndëve të asistencës sociale që ende presin për mbështetje, por që në mungesë të buxhetit për subvencione për asistencë sociale kanë mbetur të pakryera. Ndërsa, përmes librave të protokollit janë pranuar edhe 7,174 lëndë. Gjithsej lëndë të pranuar dhe të përcjella nga zyra pritëse për vitin 2011 kanë qenë 39,322.

Tabela 2: Lëndët e pranuar përmes intranetit sipas drejtorive për vitin 2011

Drejtoritë	Pranuara	Miratuara	Refuzuar	Hedhura poshtë	Pezulluar	Pakryera
1. Drejtoria e Administratës	2,419	2,094	5	9	-	311
2. Drejtoria e Shënd dhe Mir. Sociale	1,105	590	32	2	-	481 *
3. Drejtoria e Arsimit	789	361	181	-	199	48
4. Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit	2,901	2,441	145	-	52	263
5. Drejtoria e Urb. Nd. dhe Mbr. së Mjed.	1,136	818	-	-	-	318
6. Drejtoria e Infrastrukturës Lokale	585	28	-	-	557	-
7. Drejtoria e Shër. Pub., Mbroj. dhe Shp.	1,058	456	23	-	543	36
8. Drejtoria e Kulturës, Rin dhe Sp.	475	309	151	-	-	13
9. Drejtoria e Inspektionit	3,502	3,443	1	-	-	58
10. Drejtoria për Financa dhe Pronë	3,925	3,541	189	3	5	187
11. Drejtoria e Kadastrit	4,253	3,874	3	-	85	291
Gjithsej	22,148	17,955	730	14	1441	2,008

* Këto lëndë të pakryera janë kërkesa pothuajse të gjitha të asistencës sociale për barna dhe ndihmë tjetër, të cilat presin në radhë për mbështetje varësisht nga buxheti që ka komuna për subvencionim të rasteve të tilla.

Lëndët të pranuar në librat e protokollit prej 17,174 kanë qenë të natyrave të ndryshme, si: vërtetime mbajtës familje, dhe ndihmë juridike 801, libri i ekspedicionit në vend 2,985, libri i dorëzimit të postës personalisht 2,029, libri i faturave hyrëse 1,400, libri i protokollit për konkurse etj 4,288, libri i protokollit për vërtetime të asistencës sociale 4,896, libri i shtetësisë 775.

5. DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Në vitin 2011, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) veprimtarinë e vet e ka zhvilluar përmes sektorit të shëndetësisë dhe sektorit të mirëqenies sociale. DSHMS ka vazhduar me realizimin e projekteve të filluara në vitin 2010 dhe ka filluar dhe përfunduar procedurat dhe punët në lidhje me projektet e reja të planifikuara për vitin 2011.

Drejtoria ka qenë e angazhuar në menaxhimin e përditshëm të aktiviteteve në kuadër të Drejtorisë, QKMF, QMU si dhe 3 QPS. Drejtoria ka bashkëpunuar ngushtë me OJQ lokale

dhe ndërkombëtare në përpjekje për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në kujdesin parësor si dhe në zbutjen e problemeve sociale në Komunën Prishtinë. Sektori i mirëqenies sociale, pjesën më të madhe të kohës ka kushtuar aktivitetet rreth përzgjedhjes së përfituesve të banesave sociale.

a. Të dhënat për stafin dhe shërbimet shëndetësore

Në Komunën e Prishtinës, shërbime të mjekësisë familjare aktualisht ofrojnë 135 mjekë, prej tyre 100 specialistë të mjekësisë familjare dhe 35 mjekë të përgjithshëm. Shërbime konsultative specialistike ofrojnë 63 specialistë të lëmive tjera, prej tyre: 19 pediatria, 3 internistë, 8 dermatovenerologë, 8 gjinekologë, 9 specialistë të mjekësisë së punës, 3 biokimistë, 3 radiologë, 4 pneumoftiziologë, 1 specialist i epidemiologë, 1 specialist i higjienës, ORL, 1 reumatolog, 1 oftalmolog dhe 1 sociolog. Numri i stafit me kualifikim të mesëm shëndetësor (infemrierë të përgjithshëm, laborantë, teknik të radiologjisë) është rreth 360. Shërbime profesionale stomatologjike ofrojnë 47 stomatologë dhe rreth 60 asistentë/teknik të stomatologjisë. Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente janë të punësuar 21 mjekë, prej tyre 2 specialistë të urgjencës, 2 internista, 6 specialistë të mjekësisë familjare dhe 11 mjekë të përgjithshëm. Numri i infermierëve është 38. Shërbime të mirëqenies sociale në kuadër të Qendrave për Punës Sociale (QPS) në Komunën e Prishtinës ofrojnë 49 të punësuar.

Numri përgjithshëm i shërbimeve shëndetësore të realizuara nga ana e QKMF gjatë vitit 2011, i shprehur në numra është 1,853,058, që krahasuar me vitin paraprak është për rreth 13% më shumë. Mesatarisht brenda 1 dite ofrohen rreth 5,000 shërbime shëndetësore. Raporti detaj i shërbimeve shëndetësore është prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 3: Raporti i shërbimeve shëndetësore në QMF për vitin 2011

Nr.	Shërbimet shëndetësore	Vizitat mjekësore	Shërbimet tjera shëndetësore (intervenimet)	Shërbimet laboratorike	Shërbimet radiologjike	Totali
1	QKMF	20,6313	156,041	308,742	21,603	692,699
2	QMF 1	40,791	23,069	63,855		127,715
3	QMF 2	30,764	30,060	9,742		70,566
4	QMF 3	33,142	26,752	42,929		102,823
5	QMF 4	67,764	34,424	23,669		125,857
6	QMF 5	118,784	57,842	50,101		226,727
7	QMF 6	62,218	28,700	41,352		132,270
8	QMF 7	12,735	7,001	10,754		30,490
9	QMF 8	0	2,441			2,441
10	QMF 9	9,315	4,542			13,857
11	QMF 10	3,817	2,678			6,495
12	QMF Hajvali	22,764	9,864	10,326		42,954
13	QMF Besi	12,688	10,739	2,517		25,944
14	QMF Matiçan	9,293	4,059	6,760		20,112
15	Stomatologji	57,584	60,714		5,259	123,557
16	Laborator	61,454				61,454
17	Radiologji	20,897				20,897
18	Fshatrat	20,034	6,166			26,200
	Totali	790,357	465,092	570,747	26,862	1,853,058

Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente (QMU), gjatë këtij viti janë realizuar 36,287 shërbime shëndetësore, prej të cilave 9,380 vizita mjekësore në terren, 11,136 vizita mjekësore në

objektin e QMU-së, 117 reanimime, 4,102 shërbime të infermierisë e kështu me radhë Raporti detal i këtyre shërbimeve është prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 4: Raporti i shërbimeve shëndetësore të QMU për vitin 2011

	Vizita mjek. ne terren	Vizita mjek. ne QMU	Sherbime kirurgjike	Sherbime te reanimimit	Sherbime gjysem - intensive	Sherbime te infermierise	Aksidente	Fatkeqesi	Sherbime Laboarator.	EKG	Transporte	Konstatime vdekje	TOTAL
Janar	883	1002	50	9	423	457	47	57	158	151	138	35	3,410
Shkurt	739	790	48	4	283	336	46	40	121	91	106	31	2,635
Mars	890	1034	40	2	319	322	36	35	191	132	98	33	3,132
Prill	790	941	54	10	316	311	57	65	180	116	113	36	2,989
Maj	856	976	52	12	404	373	63	84	179	109	183	36	3,327
Qershor	850	819	53	40	29	354	255	78	154	94	138	24	2,888
Korrik	860	952	78	22	378	317	64	53	146	123	112	290	3,395
Gusht	714	1031	59	2	456	395	79	61	143	108	109	21	3,178
Shtator	692	1008	62	9	377	319	73	55	160	220	307	22	3,304
Tetor	707	901	57	3	197	320	46	52	151	75	125	31	2,665
Nëntor	703	858	53	0	289	283	61	52	224	73	128	26	2,750
Dhjetor	696	824	22	4	249	315	56	41	185	79	121	22	2,614
Total	9,380	11136	628	117	3,720	4,102	883	673	1,992	1,371	1,678	607	36,287

Me gjithë përpjekjet e bëra në modernizimin e këtyre qendra dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve mjekësore, në qendrat e mjekësisë familjare vazhdimisht ka mungesë të furnizimit me barna nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë. Kjo gjendje po vazhdon megjithë kërkesat e vazhdueshme të drejtorisë dhe planifikimeve shumë më herët që bëhen nga qendrat e mjekësisë familjare.

b. Investimet kapitale

Gjatë vitit 2011, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për investime kapitale ka pasur në dispozicion 1 milionë e 680 mijë euro për projekte të ndryshme.

1. Ka përfunduar ndërtimi i objektit banesor për familjet në asistencë sociale. Është bërë përzgjedhja e përfituesve të banesave sociale dhe 48 familjet përfituese janë vendosë në banesa.
2. Është ndërtuar objekti banesor kolektiv për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Është miratuar edhe Rregullorja përkatëse nga ana e Kuvendit Komunal - Rregullorja për dhënie e banesave në shfrytëzim me qira për anëtarët e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së.
3. Ka filluar ndërtimi i objektit të QMF IV, me lokacion në rrugën “Bajram Bahtiri” (te Medreseja); objekti ka një sipërfaqe prej rreth 1,220 m² në total, prej të cilave Sutereni 120 m², Përdhesa 550 m² dhe Kati I me 552 m². Shërbimet shëndetësore që do të ofrohen: mjekësia familjare, pediatrike, stomatologjike, të vaksinimit, si dhe për herë të parë në këtë pjesë të qytetit edhe shërbimet e rentgenologjisë.

4. Janë përmbyllur punët rreth ndërtimit të rrethojës dhe rregullimit të oborrit në QMF në Velani, e cila prej muajit Qershor 2011 ka filluar të ofrojë shërbime shëndetësore;
5. Është blerë një aparat i rentgenit për nevojat e QMF V, në lagjen Dardani ku nga fundi i muajit Dhjetor, për herë të parë kanë filluar të ofrohen shërbimet e radiologjisë në këtë QMF.
6. Në përfundim i sipër është rregullimi/ndërtimi i meskatit të QMF në lagjen “Arbëria”.
7. Kanë përfunduar të gjitha procedurat dhe është nënshkruar kontrata për blerjen e 2 automjeteve – kombi për bartjen e pacientëve në hemodializë.
8. Është blerë një autoambulancë me pajisje mjekësore për nevojat e QMU, dhe nga fundi i muajit Dhjetor është aktivizuar shërbimi emergjent në QMF “Kodra e Trimave”, ku një ekipë mjekësore do të jetë në gjendje gatishmërie nga ora 08:00 – 19:00 për të qenë më afër qytetarëve në këtë lagje të qytetit.
9. Dezinsektimi Hapësinor të Prishtinës sivjet është realizuar në 4 faza, duke filluar në gjysmën e muajit Qershor dhe ka përfunduar në gjysmën e dytë të muajit Gusht.
10. Deratizimi vjeshtor i podrumëve dhe garazhave publike në qytetin e Prishtinës është realizuar në periudhën kohore fundi i muajit Tetor – fillimi i muajit Nëntor.2011; janë trajtuar 102,250 m² sipërfaqe të podrumëve dhe garazheve kolektive.
11. Deratizimi vjeshtor i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prishtinës; janë trajtuar 4832 puseta, përkatësisht rreth 150 Km rrjet i kanalizimit.
12. Kanë përfunduar punët për rrethojën e oborrit të QMF në lagjen Mati-1.
13. Ka përfunduar renovimi i hapësirave të QKMF si: salla e trajnimeve dhe renovimi i katit të parë të QKMF e cila tashmë edhe është funksionalizuar; Mjekësia e Punës në QKMF; janë realizuar edhe renovime dhe sanime tjera, psh. në Ambulancën në Bardhosh, Qendrën e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, në QMF V në Dardani, etj.
14. Janë blerë pajisje mjekësore për nevojat e QKMF dhe QMU, si: aparate laboratorike – bikomike, hematologjike, pajisje për nevojat e stomatologjisë, etj., në mes tjerash edhe karrige stomatologjike; nga muaji Korrik 2011 kanë filluar të ofrohen shërbimet stomatologjike për herë të parë në QMF në “Kodrën e Trimave”; poashtu është siguruar edhe një karrige stomatologjike dhe kanë filluar shërbimet stomatologjike dhe në QMF në Kalabri.

c. Mirëqenia Sociale

Një kujdes i veçantë i është kushtuar edhe mbarëvajtjes së punëve në qendrat për punë sociale. Numri i përgjithshëm i familjeve shfrytëzuese të asistencës sociale gjatë vitit 2011, mesatarisht është rreth 2,773 familje në muaj. Tabela në vijim paraqet të dhënat për familjet në asistencë sociale në të tri qendra për punë sociale të Komunës së Prishtinës.

Tabela 5: Numri i familjeve në asistencë sociale sipas QPS dhe muajve për vitin 2011

Muaji	QPS “Qendra”	QPS “Kodra e Trimave”	QPS “Kodra e Diellit”	Totali
Janar	750	1,339	718	2,807
Shkurt	746	1,331	734	2,811
Mars	757	1,394	744	2,895
Prill	754	1,349	725	2,828
Maj	737	1,349	723	2,809
Qershor	729	1,329	671	2,729
Korrik	727	1,329	700	2,756
Gusht	715	1,334	720	2,769
Shtator	694	1,332	704	2,730
Tetor	695	1,297	688	2,680
Nëntor	686	1,283	701	2,670
Dhjetor	776	1,304	709	2,789
Mesatarja vjetore	731	1,331	711	2,773

Sektori i mirëqenies sociale, pjesën më të madhe të kohës gjatë kësaj periudhe i ka kushtuar aktiviteteve rreth përzgjedhjes së përfituesve të banesave sociale. Pas miratimit të listës përfundimtare të përfituesve nga ana e KK, 48 familje janë vendosur në banesa në fillim të muajit Nëntor 2011.

Në kategorinë e subvencioneve, janë përkrahur me mjete financiare OJQ si dhe individë të sëmurët rëndë si raste sociale në sigurimin e medikamenteve dhe trajtim mjekësor në shumë të përgjithshme prej rreth 90,000 Euro. Në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar në vitin paraprak me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për implementimin e projektit “Një shujtë për të gjithë”, ka vazhduar ofrimi i shujtës ushqimore për familjet që janë në varfëri të skajshme, përmes së cilit projekt për çdo muaj janë siguruar nga 300 shujta për këto familje.

Edhe gjatë vitit 2011 ka vazhduar parashtrimi i kërkesave në Sektorin e Mirëqenies Sociale; kështu, numri i përgjithshëm i kërkesave të parashtruara ishte 614; numri më i madh i këtyre kërkesave, rreth 90% e tyre ka qenë për ndihmë emergjente financiare kryesisht kërkesa për ushqim dhe barna, vërtetime për trajtim mjekësorë jashtë vendit, etj; kurse nga viti 2010 janë bartur 456 lëndë të mbetura për ndihmë emergjente financiare, edhe këto kryesisht kërkesa për sigurimin e barnave dhe ushqimit.

Nga kërkesat e parashtruara, janë lejuar 580 kërkesa për ndihmë emergjente, në shumë prej 70 – 100 Euro secila prej tyre. Janë miratuar 8 kërkesa për përkrahje financiare të OJQ-ve. Janë ekzekutuar 317 vërtetime për shërim jashtë vendit. Janë paraqitur gjithsej 49 kërkesa për realizimin e të drejtave të personave sipas Ligjit mbi familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe viktimave civile të luftës në Kosovë, nga të cilat 48 kanë marrë përgjigje pozitive, ndërsa për një rast pala nuk ka kompletuar dokumentacionin e nevojshëm. Gjatë kësaj periudhe kohore janë pranuar gjithsej 16 lëndë nga QKMF në Prishtinë që tu sigurohen të drejtat e punëtorëve me rastin e pensionimit për shkak të moshës, prej tyre 9 lëndë janë ekzekutuar ndërsa 7 të tjera barten në vitin e ardhshëm. Përfaqësues të DSHMS kanë marrë pjesë seminare, konferenca dhe trajnime të ndryshme, si në trajnimin një ditor për reintegrimin e personave të riatdhesuar, të organizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme; po ashtu edhe në takimet e rregullta të Kolegjiumit të Drejtorëve Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, dhe takime e konferenca tjera profesionale, brenda dhe jashtë Kosove.

Gjatë fund të muajit maj kanë ndodhur vërshime në disa lagje të Prishtinës, si në: Kodrën e Trimave, Shkabaj dhe Hajvali. Me këtë rast është paraqitur nevoja e menaxhimit të situatës në kuptim të ruajtjes së shëndetit publik të qytetarëve dhe parandalimit të ndonjë epidemie të mundshme. Për këtë qëllim, krahas masave të përgjithshme kundërepidemike, është ndërmarrë dhe realizuar me sukses edhe një projekt për dezinfektimin e objekteve të banimit, oborreve dhe objekteve përcjellëse të këtyre lagjeve, projekt ky që është implementuara gjatë muajit qershor.

d. Bashkëpunimi me donatorët

Në kuadër të bashkëpunimit me MSH, Komuna e Prishtinës është përfshirë në pilot projektin e financuar nga Qeveria e Luksemburgut për implementimin e Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH) në institucionet shëndetësore. OBSH gjatë këtij viti ka dhuruar donacion të pajisjeve për trajnime profesionale në QMU, në vlerë rreth 16,000 Euro si dhe ka mbajtur edhe trajnimet e stafit të QMU në temën “First person in side”. Në kuadër të projektit të përbashkët të Qeverisë së Luksemburgut me MSH për përkrahjen e Shëndetësisë Kosovare është siguruar donacion një autoambulancë për nevojat e QMU (Qendrës së Mjekësisë Urgjente). Në bashkëpunim me Asociacionin e Osteoporozës së Kosovës është realizuar projekti për Skriningun e popullatës për Osteoporozë me Densitometër me ultratingull, ku gjatë periudhës Shtator-Dhjetor 2011 në Qendrat e Mjekësisë Familjare në Prishtinë janë trajtuar rreth 600 pacientë. Këto shërbime janë ofruar falas.

Janë realizuar edhe aktivitete tjera në fushën e trajnimeve, seminareve, qoftë përmes pjesëmarrjes së profesionistëve shëndetësorë në kongreset jashtë Kosove, qoftë përmes seminareve dhe organizimeve tjera brenda në Kosovë, si p.sh.: fillimi i implementimit të projektit për “Zbatimin e Standardeve për Rritjen e Shëndoshë të Fëmijëve prej 0-5 vjeç”, projekt ky gjatë të cilit në vitin paraprak me mbështetjen e zyrës së OBSH në Prishtinë është bërë trajnimi i stafit mjekësor; paraprakisht, të gjitha QMF dhe Ambulancat mjekësore janë pajisur me pajisje përkatëse – peshore dhe pajisje për matje të gjatësisë, të gjitha këto donacion nga OBSH. Gjatë muajit dhjetor është realizuar projekti “Informohu Drejtë – Shpëto Jetë” nga ana e OJQ “Anti DANS” gjatë të cilit projekt stafi shëndetësor është informuar/trajnuar lidhur me mënyrat e parandalimit, mundësitë e diagnostikimit dhe sigurisë në vendin e punës nga infeksioni me HIV/AIDS.

Drejtoria po ballafaqohet edhe me mungesë të buxhetit për Qendrat për Punë Sociale, pasi MPMS nuk e ka bartur në komunë buxhetin adekuat me rastin e decentralizimit të shërbimeve sociale. Disa kompani dhe individë kanë dhënë kontribut të rëndësishëm dhe kanë përkahur komunën në mbështetje të rasteve sociale, të cilat komuna për shkak të kufizimeve buxhetore për asistencë sociale nuk ka mundur t’ju dalë në ndihmë. Në bashkëpunim me një kompani private vendase janë siguruar pako familjare ushqimore për 30 familjeve në nevojë me rastin e festës së Bajramit. Edhe për festat e fund vitit, është siguruar një donacion nga rrjeti rinor “Rilindja”, ku 80 familje kanë përfituar nga një pako ushqimore në vlerë prej rreth 50 Euro. Janë përkrahur edhe shumë projekte, në veçanti ato të OJQ-ve që punojnë në fushën e personave me aftësi të kufizuara, si dhe grupet tjera vulnerable të popullatës. Një numër i madh i lëndëve të pazgjidhura që kanë mbetur në këtë drjetori janë kërkesa për asistencë sociale, të cilat nuk janë përkrahur në mungesë të buxhetit për subvencione për asistencë sociale. Komuna këto kërkesa do t’i trajtojë në vitin 2012 në bazë të kapaciteteve buxhetore për raste të tilla.

6. DREJTORIA E ARSIMIT

Drejtoria e Arsimit, gjatë vitit 2011 ka punuar në mbarëvajtjen e procesit mësimor, në realizimin e investimeve kapitale për ndërtimin dhe meremetimin e objekteve shkollore, objekteve sportive, trajtimin dhe ruajtjen e objekteve shkollore, inventarit dhe pasurive të tjera, në krijimin e kushteve më të mira për ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe monitorimin e procesit mësimor.

a. Të dhëna për arsimin në Komunën e Prishtinës

Në nivelin parauniversitar, në Komunën e Prishtinës, edukimi dhe arsimimi i fëmijëve dhe nxënësve u zhvillua në 9 institucione parashkollore publike, 5 institucione parashkollore private, 40 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta publike dhe 23 paralele të ndara fizike, 5 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta private, 12 shkolla të mesme të larta publike dhe 5 shkolla të mesme të larta private. Në të gjitha këto institucione arsimore janë të përfshirë gjithsej 53,084 fëmijë dhe nxënës të organizuar në 2,154 paralele.

Në institucionet parashkollore publike, gjatë vitit 2011, kanë qenë të sistemuar 1,774 fëmijë të të gjitha grupmoshave, ndërsa në ato private rreth 654 fëmijë. Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ultë publik, mësimin e kanë ndjekur 35,390 nxënës të shpërndarë në 1,417 paralele (prej tyre 161 nxënës turq, 72 nxënës serb dhe 23 nxënës boshnjak). Në shkollat fillore private mësimin e ndoqën 1,128 nxënës. Nga këto të dhëna rezulton se mesatarja e nxënësve në paralele në këtë nivel ishte 25 sish. Po ashtu, në shkollat e mesme të larta publike mësimin e ndoqën 13,388 nxënës (prej tyre 94 turq dhe 16 boshnjak) të sistemuar në 402 paralele, ndërsa numri mesatar i nxënësve në paralele ishte 34. Në shkollat e mesme të larta private mësimin e ndoqën 1,622 nxënës. Në të gjitha këto shkolla publike në të tri nivelet janë të punësuar 3,340 mësimdhënës dhe shërbyes të tjerë për mësim në të gjitha gjuhët, kurse në shkollat private 185.

b. Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor

Gjatë kësaj periudhe zyrtarët arsimorë kanë realizuar 101 vizita informative, 22 vizita të përgjithshme, 31 vizita profesionale, 19 vizita speciale dhe 11 vizita kthyesë. Zyrtarët e arsimit, gjatë realizimit të vizitave nëpër shkolla, kanë kontrolluar dokumentacionin pedagogjik, plan-programet mësimore, kanë monitoruar punën e mësimdhënësve sipas planit-mbështetur në kapacitetet e drejtorisë, I kanë kontrolluar objektet shkollore dhe funksionalitetin e tyre, kanë përcjellë shkallën e vijueshmërisë së nxënësve, mësimdhënësve dhe të punësuarve tjerë nëpër shkolla. Kanë përcjellë shkallën e funksionimit të organeve profesionale dhe administrative të institucioneve shkollore, shkallën e bashkëpunimit me prindër, me institucionet tjera dhe shoqërinë civile. Ky shërbim ka analizuar vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve në mësim sipas periodave mësimore. Janë bërë vlerësimet dhe janë dhënë propozim-masat për përmirësime eventuale, sipas nevojës.

c. Shërbimi i administratës

Gjatë kësaj periudhe njëvjeçare, në Drejtorin e Arsimit kanë arritur 789 lëndë, prej të cilave janë miratuar 361, janë refuzuar 181, janë pezulluar 199 lëndë, ndërsa 48 lëndë janë bartur në vitin 2012. Gjatë kësaj kohe janë shpallur konkurset për pranimin e kuadrove në shkolla në të tri nivelet, si dhe konkurset për emërimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve që iu ka

skaduar kontrata. Është bërë përgatitja e konkursit për praninë të nxënësve në shkollat e mesme të larta, i cili është shpallur nga Ministria e Arsimit.

d. Shërbimi i financave

Shërbimi financiar ka realizuar objektivat dhe detyrat e punës sipas planit:

- Sigurimin e shënimeve statistikore për planifikimin e buxhetit
- Planifikimin e buxhetit
- Ndarjen e buxhetit sipas programeve dhe nën-nënprograme,
- Trajnimin e drejtorëve të institucioneve arsimore për buxhet dhe financa
- Pranimin dhe kompletimin e dokumentacionit për pagesë,
- Zotimin dhe shpenzimin e mjeteve financiare,
- Përgatitjen e tenderëve për mallra dhe shërbime,
- Raportet Financiare për të gjitha kategoritë e shpenzimeve dhe të gjitha programet dhe nën-nënprogramet,
- përgatitja dhe shpërndarja e parasë së gatshme etj.

e. Ngritja e infrastrukturës shkollore

Gjatë vitit 2011 janë lëshuar në punë objektet shkollore të filluara viteve të mëparshme, ka filluar ndërtimi i disa objekteve shkollore, anekseve, objekteve të sportit të cilat po ashtu janë inauguruar brenda këtij viti dhe ka filluar ndërtimi i disa objekteve të cilat nuk janë përfunduar, por vazhdojnë të ndërtohen gjatë vitit 2012. Me objektet e reja të cilat janë përfunduar gjatë këtij viti Komuna e Prishtinës e ka shtuar hapësirën shkollore për 24,324 m², duke llogaritur vetëm hapësirat e objekteve shkollore. Kështu, hapësirës mesimore për kokë nxënësi nga 1.50 m² sa ishte në vitin 2010, gjatë vitit 2011 është rritur në 1.60 m².

Inaugurimi i objekteve të bartura nga viti 2010:

- Objekti i shkollës për edukimin special, në lagjen Kalabria(MASHT).....4,200 m2
- Objekti i shkollës fillore ne Hajvalia II,.....3,975 m2
- Terreni sportiv në shkollën fillore “A.rrustemi-Suteske.....1,500 m2
- Terreni sportiv në shkollën fillore “G.Terbeshi” , Siqeve.....1,500 m2
- Terreni sportiv në shkollën fillore “Aferdita-Dabishec”,1,500 m2
- Terreni sportiv në shkollën fillore “N.Tereze-Vranidoll”,1,500 m2
- Rrethoja e oborrit të shkollës fillore”F.Shiroka-Slivove,
- Rrethoja e oborrit të shkollës fillore Shashkoc
- Rrethoja e oborrit të shkollës fillore”Tefik Çanga” Koliq, PNF në Podaj
- Rregullimi i oborrit dhe rrethoja për shkollën fillore “H. Rakovica” në Prishtinë,
- Rregullimi i oborrit të shkollës fillore “Mitrush Kuteli” në Mat,
- Rrethoja e oborrit të shkollës fillore “Pavarësia” në Prishtinë

Inaugurimi i objekteve të filluara në vitin 2011:

- Aneksi i shkollës se gjimnazit“Aneksi i gjimnazit Sami Frasheri”, 3,864 m2
- Aneksi i shkollës fillore “7 Marsi, në Prishtinë.....1,600 m2
- Aneksi ne IP-Fatosat,.....400 m2

Projektet që kanë filluar këtë vit dhe të cilat vazhdojnë në vitin 2012:

- Objekti i ri i shkollës mesme Ekonomike..... 4,735,5 m2
- Objekti i shkollës fillore në lagjen “Arbëria” të Prishtinës.....2,305,9 m2

- Aneksi i shkollës fillore “Meto Bajraktari, në Prishtinë.....4,280 m2
- Salla e edukatës fizike në gjimnazin “Xh.Doda”.....600 m2
- Salla e edukatës fizike në shkollën e mesme Ekonomike.....670 m2

Projektet që janë të financuara nga niveli qendror:

- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore “N. Gafurri”, Prishtinë
- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore “Xh. Ahmeti”, Prishtinë
- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shkollën fillore “Pavarëia”, Prishtinë
- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në SHME “Gjin Gazulli”, Prishtinë
- Rregullimi i oborrit dhe terreni sportiv në shk. fillore “Meto Bajraktari”, Prishtinë

Projektet që janë të financuara nga Swiscontact dhe komuna Komuna:

- Renovimi i objektit të shkollës së mesme Bujqësore, Prishtinë

Objektet shkollore që kanë filluar dhe janë në realizim e sipër, financim i MASHT-it:

- Objekti i shkollës së mesme në Kalabri (pranës shkollë bujqësore)5,850 m2
- Objekti i shkollës së mesme në lagjen Kalabria, (te Trafiku Urban),.....5,850 m2
- Objekti i shkollës së mesme në lagjen Çamëria,5,850 m2

Objektet shkollore për të cilat janë bërë përgatitjet dhe që pritet të realizohen gjatë vitit, me financim të MASHT-it dhe Bankës Botërore:

- Objekti i shkollës fillore të Tjegullorja”Shkolla Model”6,000 m2

Gjatë vitit 2011, janë bërë meremetime dhe rikonstruime të objekteve shkollore si në vijim:

- Gëlqerosja e 18 objekteve shkollore
- Fasadimi i 4 objekteve shkollore
- Ndërrimi i dritareve në 4 objekte shkollore
- Rikonstruime të kulmeve në objektet e katër shkollave
- Rikonstruimi i kulmeve, dritareve dhe rregullimi i oborreve në tri objekte të shkollave fillore:
- Pajisje e shkollave me kabinete, inventar, libra dhe pajisje tjera
- Instalime të reja dhe rikonstruime të ngrohjes qendrore
- Renovimi i objektit të vjetër të shkollës fillore “Nazim Gafurri”, Prishtinë – pjesa e mbetur si dhe nyjet sanitare nga Komuna
- Renovimi i nyjeve sanitare të shkollës fillore “Naim Frasheri”, Prishtinë - – me bashkëfinancim Komuna/USAID
- Renovimi i nyjeve sanitare të shkollës fillore “Faik Konica”, Prishtinë - – me bashkëfinancim Komuna/USAID

f. Aktivitetet e tjera të drejtorisë

Janë organizuar Garat e Diturisë që tashmë janë tradicionale, pastaj garat e matematicientëve në kuadër të Olimpiadës së Matematikës, garat “Gjuhëtari i Ri” në nivel komunal dhe republikan si dhe varg garash sportive në disiplina të ndryshme sportive. Drejtoria e Arsimit ka bërë të gjitha përgatitjet për organizimin e testeve kombëtare, në kuadër të përgjegjësisë që i takojnë, dhe ka bërë administrimin e testit të klasave të pesta, testit të maturës si dhe testit të arritshmërisë për klasat e nënta (9-ta).

Drejtoria për Arsim ka pasur një bashkëpunim të suksesshëm dhe ka organizuar trajnime në bashkëpunim me MASHT-in dhe organizata tjera si:

- Qendra e Arsimit të Kosovës (KEC),
- Komisioni Evropian: trajnime për Edukatë qytetare,
- Organizata CESES: trajnime për Formim dhe zhvillim,
- Foundation Together Slovenia dhe Fondacioni Together Kosova: Qendra Rajonale për Mirëqenie Psikosociale të Fëmijëve,
- Klubi Kosovar për Energji dhe Mjedis /KKEM/: Zhvillimi dhe rritja e njohurive mbi çështjet e mjedisit dhe të burimeve të energjisë në mesin e të rinjve dhe të shoqërisë civile,
- GTZ: Trajnime për udhëheqje të shkollës,
- SWISS-CONTACT: firmat ushtrimore,
- Word Learning: trajnime i mësimdhënësve të gjuhës angleze,
- Banka Botërore: trajnime për hartimin e planeve zhvillimore të shkollave dhe realizimi i projekteve përmes granteve shkollore.
- USAID- AED: Zbatimi i Kurrikulumit të ri

7. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) gjatë vitit 2011, ka realizuar objektivat në bazë të politikave programore dhe prioriteteve për investime kapitale bazuar në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve dhe hulumtimet në teren. Gjithashtu, është parapare buxheti për shënimin e festave dhe ngjarjeve të mëdha kulturore komunale dhe shtetërore. Janë pranuar, shqyrtuar dhe proceduar kërkesat për subvencionim të projekteve bazuar në planin e DKRS-së. Drejtoria ka pranuar gjithsej 475 lëndë, prej të cilave janë miratuar 309, janë refuzuar 151 lëndë dhe kanë mbetur të pakryera 13 lëndë.

a. Investimet kapitale

Gjatë vitit 2011, në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit janë investuar 2,350,148 € në këto projekte kapitale:

1. Ndërtimi i Bibliotekës së Qytetit “Hivzi Sylejmani”, që vazhdon nga viti 2010 në vlerë totale prej 1,502,443 €,
2. Renovimi i Teatrit Dodona, shuma totale 20,918 €,
3. Furnizimi me inventar për shtëpizat e Qendrës Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës, shuma totale 15,390 €
4. Xhamia e Çarshisë, që vazhdon nga viti 2010, ku Instituti për Ruajtjen e Monumenteve të Republikës së Kosovës ka realizuar projektin ideor, ndërsa investitor është Komuna e Prishtinës, shuma totale 330,000 €,
5. Ndërtimi i tri terreneve sportive në lagjen Bregu i Diellit, shuma totale 64,720 €,
6. Ndërtimi dhe renovimi i terreneve sportive në lagjet Kodra e Diellit, Ulpiana dhe Dardania, në shumë totale prej 74,700 €.
7. Ndërtimi i terreneve për basketboll dhe këndet për fëmijë në lagjet Velania dhe Kodra e Trimave, shuma totale 108,720 € (punimet janë në vazhdim),
8. Panoramën e Bjeshkatarisë në Gërmë, shuma totale 36,758 €
9. Furnizimi dhe montimi i rafteteve në Arkivin e Prishtinës, pjesa e parë ka kushtuar 18,758 € dhe pjesa e dytë ka kushtuar 11,581 €,
10. Furnizimi me libra për bibliotekën e qytetit dhe shkollat e Prishtinës, shuma totale 33,030 €.

11. Varrezat e Dëshmorëve, faza e parë e projektit ka përfunduar, shuma totale 58,000 €,
12. Stolisja e qytetit për festat e fund vitit, shuma totale 34,788 €,
13. Hamami i qytetit, projekti për instalimin e rrymës elektrike, ngrohjes dhe klimatizimit, shuma totale 9,100 €,
14. Renovimi për krijimin e kushteve të hapësirave të qendrës rinore, shuma totale 50,000 €.

b. Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme kulturore

Në programin për shënimin e festave dhe ngjarjeve të mëdha kulturore komunale dhe shtetërore, kombëtare dhe ndërkombëtare, për vitin 2011, drejtorja ka investuar shumë prej 103,138 euro: Tre vjetori i shpalljes së Pavarësisë, Dita e Dëshmorëve të Prishtinës, Dita e Evropës 2011, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, Dita e Prishtinës ‘11 Qershori’, Dita e pavarësisë së SHBA-ve, Mbrëmjet verore ”Vera ne Prishtine”, Festivali i Parë i Teatrove te Kukullave, Festivali Ndërkombëtar i Fëmijëve “YLBERI I PRISHTINËS”, Muaji i Rinisë, Dita e Flamurit 28 Nëntori, Ndriçimi dhe zbukurimi i qytetit për festat e fund vitit, Festa e vitit të ri, Sportisti i vitit 2011 dhe Turneu memorial i shahut ‘Hyzri Talla’, Pjesëmarrja ne Festivale ndërkombëtare etj.

Gjithashtu, drejtorja ka bashkëpunuar edhe me organizata të ndryshëm duke u ofruar ndihmë logjistike dhe organizative lidhur me këto ngjarje: Dita e mësuesit, Dita Ndërkombëtare e Gruas, Ditët e Bibliotekës, Festa e muzikës, Kampingjet në futboll – Prishtinë, Dita ndërkombëtare e rinisë, Dita e kancerit te gjirit, Seminari “Përgatitje mendore në sport dhe jetën e përditshme” etj.

c. Sektori për kulturë

Gjatë vitit 2011, në fushën e kulturës me një shumë të përgjithshme prej 167,391 €, janë përkrahur 176 projekte të ndryshme:

- 88 botime të ndryshme	54,700 €
- 8 veprimtari teatrore	8,850 €
- 15 festivale kombëtare dhe ndërkombëtare	28,600 €
- 5 projekte të arteve pamore – ekspozita	3,971 €
- 36 projekte të asociacioneve kulturore	41,000 €
- 17 projekte mbi çështje gjinore dhe asamblesë komunale të fëmijëve	10,100 €
- 4 projekte të Teatrit Dodona	14,000 €
- 3 projekte të Qendrës Kulturore të Fëmijëve	6,170 €

Me rastin e 25 vjetorit të teatrit të qytetit “Dodona” është themeluar festivali i parë i teatrove të kukullave. Është kremtuar 50 vjetori i Qendrës Kulturore të Fëmijëve. Drejtorja ka fituar fonde të programit të USAID-it në kuadër të Iniciativës për Komuna Demokratike dhe Efektive për të mbështetur projektin “Klubi i Animatorëve”. DKRS është para përfundimit të rregullimit të hapësirës për nevojat e klubit përfitues, të cilët do të janë nxënës të shkollave të Prishtinës.

Në kuadër të bashkëpunimit me Ambasadën e Kosovës në Austri, shoqata “Flame of Peace”, e udhëhequr nga pasardhësit e familjes mbretërore të Austrisë të Habsburgëve, në dhjetor në lagjen Ulpiana u vendos në kryeqytet “Statuja e Paqes”. Po ashtu, në kuadër t këtij bashkëpunimi u organizua një vizitë e disa nxënësve nga gjimnazi “Xhevdet Doda” në një shkollë austriake më qëllim të binjakëzimit të tyre.

d. Sektori për sport dhe rini

Numri total i projekteve dhe klubeve sportive dhe rinore të përkrahura gjatë vitit 2011 është 91 (prej tyre 68 projekte të sportit dhe 23 projekte për rini), me një vlerë totale prej 70,290 €:

- 14 Karate	8,000 €
- 2 Voleiboll	2,000 €
- 4 Taekëando	2,300 €
- 2 Not	2,000 €
- 8 Futboll	5,700 €
- 2 Aeroklube	1,800 €
- 2 Skitari	1,200 €
- 1 Basketboll	1,000 €
- 6 Shenjtëri	2,700 €
- 2 Pink-pong	1,800 €
- 3 Hendboll	4,000 €
- 3 Shahu	1,600 €
- 2 Boks	2,000 €
- 1 Atletikë	500 €
- 1 Çiklistik	400 €
- 15 Shoqata sportive	8,200 €
- 23 Shoqata rinore	2,590 €

e. Institucionet kulturore ndër-komunale

Arkivi Komunal i Prishtinës: Gjatë këtij viti 2011, Arkivi Komunal i Prishtinës ka pranuar rreth 650 kërkesa për qasje në dokumentacion arkivorë, të kërkuara nga personat civil, organizata të ndryshme dhe Institucione shtetërore. Lëndët e fondit të Kuvendit Komunal të Prishtinës, prej vitit 1979 – 1999, janë klasifikuar në njësi organizative. Është bërë përkrahimi i fletëve të brendshme dhe janë hartuar udhërrëfyes të këtij materiali arkivorë. Megjithatë, ende mungon një sasi e materialit arkivor të këtij fondi, pasi që janë ndaluar disa kuti arkivore nga “Arkiv Ndër-komunal”, statusi i të cilit arkiv ende nuk është i qartë. Është bërë hospiti i disa regjistraturave që i përkasin Arkivit Komunal të Prishtinës. Është bërë bartja e materialit arkivorë të fondit të ish Kombinatit Ndërtimor Industrial “Ramiz Sadiku” nga depot e ndërtesës së Arkivit të Kosovës, në depot e Arkivit Komunal të Prishtinës. Sipas plan programit të punës është mundësua edhe ndjekja e trajnimit 3 ditorë lidhur me menaxhimin zyrtar në institucione. Janë mbajtur takime me përfaqësues të ASHAK-ut si dhe Agjencisë së Arkivave të Kosovës. Në përgjithësi, nga planifikimet dhe parashikimet janë realizuar përfaqësisht punët e parapara, mirëpo në mungesë të fondeve arkivore që kanë mbetur në ndërtesën e Arkivit të Kosovës nuk ka mundur të realizohet plani i punës në tërësi.

Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës: Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës ka kryer një varg aktivitetesh në lëmin e gjurmimeve mbrojtjes dhe prezantimeve të trashëgimisë kulturore: hartimi i projekt propozimit “Qytetin mesjetar të Artanës (Novobërdës)”, projekti për vazhdimin e gjurmimeve dhe konservimeve në “Memorien Veriore “ të Ulpianës, projekti për intervenime emergjente zonën kulturore - historike të Prishtinës, projekti për Sahat Kullën e Prishtinës, projekti për varrezën hebraike, projekti për kështjellën antike të Keqekollës, projekti për konservimin dhe restaurimin e bibliotekës “Hivzi Sylejmani” etj. Po ashtu janë kryer edhe konservime dhe gjurmime arkeologjike në disa lokacione. Është bërë rivlerësimi i dokumentacioni për monumente të

trashëgimisë arkitekturore në zonën kulturore historike dhe për 12 vend-zbulimeve arkeologjike në territorin e Kosovës.

Teatri i Qytetit “DODONA”: Sezoni me shfaqjet e teatrit të kukullave ka zgjatur nga 8 janar deri me 25 Dhjetor 2011. Është punuar në mënyre të vazhdueshme në skenën e teatrit të kukullave dhe në skenën e të rriturve. Janë realizuar 9 premiera: 3 në skenën e teatrit të kukullave dhe 6 në skenën e të rriturve. Në teatrin e kukullave janë realizuar premiera, ndërsa në skenën e mbrëmjes janë realizuar 4 premierat. Gjatë vitit 2011 teatri i kukullave ka realizuar mbi 90 repriza të cilat janë përcjell nga afro 12,000 shikues, respektivisht rreth 136 shikues mesatarisht në një reprizë. Skena për të rritur ka realizuar 32 repriza në skenën e teatrit ndërsa, janë realizuar edhe mbi 12 shfaqje nëpër skenat e ndryshme anë e këndë Kosovës dhe më gjerë. Shfaqjet janë shikuar nga më se 1,700 shikues ose mesatarisht rreth 40 shikues për një reprizë. Sa i përket programeve të teatrit të fëmijëve-kukullave, janë shfaqur edhe 9 programe tjera “Premierë”, që kanë qenë programe mysafire. Me rastin e 25 vjetorit të themelimit të Teatrit Dodona, është organizuar “Festivali i yeatrove të kukullave”, ku kanë marrë pjesë trupat teatrore të qytetit të Vlorës, Tiranës, Korçës dhe Prishtinës. Viti 2011 ka sjellë çmime dhe mirënjohje nga festivalet e shumta.

Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës: Gjatë vitit 2011 janë zhvilluar aktivitete të rregullta në vallëzimin modern, vallëzimin folklorik, dramën, klubin e ambasadorëve dhe klubin e letrarëve. Gjatë vitit 2011 janë realizuar 12 koncerteve dhe aktiviteteve të tjera kulturore, pjesëmarrje në festivale ndërkombëtare, manifestimi për përvjetorin e pavarësisë në Teatrin e Kukullave “Dodona” dhe premiera e shfaqjes “Gogoli”, si dhe pjesëmarrje në Koncertin e organizuar nga Komuna e Prishtinës në Sheshin “Nënë Terezë”, është mbajtur koncert në Sallën e Kuqe me rastin e 7 Marsit (Ditës së Mësuesit) dhe 8 Marsit (Ditës së Gruas), manifestimi me rastin e Ditës së Evropës, programi i ambasadorëve të vegjël, programe të valltareve të qendrës në koncertin e organizuar për Ditët e Mërgatës, Dita e Rinisë përmes paraqitjes në sheshin “Nëna Terezë”, festivali “Ylberi i Prishtinës” dhe programe të tjera. Qendra ka bashkëpunuar ngushtë me Komunën e Prishtinës në shënimin e shumë datave kulturore dhe artistike në Prishtinë.

8. DREJTORIA E FINANCAVE DHE PRONËS

a. Buxheti për vitin 2011

Komuna e Prishtinës për vitin 2011 ka pasur një buxhet të miratuar në vlerë prej 55,012,543 Euro, i cili është shtuar edhe për 4,475,176 Euro për të përballuar rritjen e pagave që ka ndodhur nga muaji mars 2011, pra gjithsej 59,687.719 euro. Nga këto mjete, 20,175,922 Euro (apo 34%) janë planifikuar nga të hyrat vetanake, ndërsa pjesa tjetër prej 66% nga grantet qeveritare: granti i përgjithshëm, granti për arsim dhe granti për shëndetësi.

b. Të hyrat vetanake

Të hyrat vetanake për vitin 2011 të planifikuara në shumën 20,175,922 euro, janë realizuar në nivel prej 94%. Në tabelën në vijim janë paraqitur të gjitha burimet e të hyrave vetanake, planifikimi dhe realizimi i tyre. Nga krahasimi i të hyrave të realizuara për vitin 2011 me të hyrat e realizuara për vitin 2010 shihet se në shumicën e të hyrave ka pasur ngritje (nga lejet ndërtimore, nga tatimi në pronë, nga shfrytëzimi i sipërfaqeve publike, nga shërbimet shëndetësore dhe arsimore etj.

Ngecje ka pasur sidomos në ato lloje të të hyrave që varen nga kërkesat e qytetarëve për dokumentacion dhe shërbime komunale si: dokumentacioni kadastral dhe gjeodezik, transaksionet e pronës etj. Një ndryshim që ka ndodhur gjatë vitit të kaluar është heqja e lejes së punës për biznese në pjesën e parë të vitit 2011, që ka bërë që të hyrat vetanake të komunës nga ky burim të bien në mënyrë drastike nga 745,461 sa kanë qenë në vitin 2010, në 450,984 në vitin 2011. Kjo bartje e kompetencave nga niveli lokal në nivelin qendror po e dëmton komunën financiarisht sa i përket të hyrave vetanake si dhe po e zvogëlon fleksibilitetin e saj në ofrimin e kushteve më të volitshme për promovimin e zhvillimit ekonomik lokal.

Në strukturën e të hyrave vetanake, pjesën më të madhe e përbëjnë të hyrat nga lejet e ndërtimit (48% në vitin 2011, ndërsa 45% kanë qenë në vitin 2010), të hyrat nga tatimi në pronë (20% në vitin 2011, po aq në vitin 2010), shfrytëzimi i sipërfaqeve publike (6.8%), participimi në arsim (6%) dhe shëndetësi (1%) etj. Të hyrat e realizuara nga lejet e ndërtimit, kanë shënuar rritje prej 5% në raport me vitin paraprak, ndërsa realizimi ka arritur në 87.8% të planifikimit. Të hyrat nga tatimi në pronë gjatë këtij viti kanë shënuar rritje rreth 2% krahasuar me realizimin e vitit të kaluar. Ngritje të konsiderueshme të të hyrave ka sidomos nga shfrytëzimi i hapësirës publike, të cilat janë rritur për 11% krahasuar me vitin e kaluar dhe gjithashtu është tejkaluar planifikimi për 9.5%.

Tabela 6: Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake në 2011

	Përshkrimi	2010			2011			Krahasimi i realizimit 2011/2010
		Planifikimi	Realizimi	% e realizimit	Planifikimi	Realizimi	% e realizimit	
1	Taksa për leje ndërtimi	10,089,764	8,564,366	85	10,200,922	8,952,261	88	105
2	Tatimi në pronën e pal.	4,220,361	3,776,197	89	4,225,000	3,844,124	91	102
3	Taksa për leje pune	700,000	745,461	106	600,000	450,984	75	60
4	Taksa për shfry. e sip. pub.	600,000	969,170	162	1,150,000	1,260,608	110	130
5	Taksa nga kadastru dhe gje.	600,000	417,025	70	500,000	344,940	69	83
6	Taksa për transakcion në pr.	730,000	677,100	93	700,000	587,290	84	87
7	Të hyra nga inspekcioni	145,000	115,001	79	150,000	65,135	43	57
8	Taksa për cer. dhe dok. Zy.	160,000	335,464	210	200,000	235,742	118	70
9	Taksa për automjete motorike	300,000	400,092	133	350,000	441,250	126	110
10	Taksa për shërbime arsimore	800,000	1,129,040	141	850,000	1,130,123	133	100
11	Taksa për shërbime shën.	200,000	193,901	97	200,000	195,215	98	101
12	Gjobat në trafik	900,000	995,580	111	900,000	723,874	80	73
13	Participime / Donacione	50,000	215,000	430	50,000	58,478	117	27
14	Të hyra tjera	60,000	89,347	149	50,000	99,044	198	111
15	Agjensioni i pyejeve	-	6,017	-	50,000	3,021	6	50
16	Gjobat nga gjykatat	-	333,516	-	-	477,056	-	143
	Gjithsej	19,555,125	18,962,277	97	20,175,922	18,869,145	94	100

c. Shpenzimet buxhetore

Shpenzimi i përgjithshëm i buxhetit për vitin 2011 ka arritur nivelin prej 80.02% të mjeteve të planifikuar prej 59,687.719 euro, ku përfshihen edhe mjetet prej 4,475,176 euro për të përballuar rritjen e pagave në nga marsi i vitit 2011 si dhe 200,000 euro të ndara nga Qeveria si subvencionim për vërshimet e ndodhura në disa lagje të Prishtinës. Shpenzimet kapitale përbëjnë pjesën më të madhe të buxhetit prej 52%.

Shpenzimet për paga dhe mëditje janë realizuar në nivelin prej 102.06%, që ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së pagave në muajin mars 2011 dhe mos transferim të mjeteve të mjaftueshme për këtë qëllim nga niveli qendror. Shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë arritur në 96%, për shpenzime komunale 91%, për subvencione dhe transfere 85% dhe për investime kapitale 62%.

Tabela 7: Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2011

Programi	Buxheti i planifikuar		Buxheti i shpenzuar	% e shpenzuar nga planifikim
	Në euro	%		
Programi	Në euro	%	Në euro	%
Paga dhe Mëditje	20,756,372	34.8	21,183,054	102.1
Mallra dhe Shërbime	4,905,856	8.2	4,717,791	96.2
Shpenzime Komunale	2,116,674	3.5	1,936,087	91.5
Subvencione dhe Transfere	763,274	1.3	651,459	85.3
Investimet Kapitale	31,145,543	52.2	19,271,691	61.9
Gjithsej	59,687,719	100.0	47,760,082	80.0

Duhet potencuar se ndikimi i shpenzimit të buxhetit, sidomos për investime kapitale, në krahasim me mjetet e planifikuara, vjen si rezultat i vonësive në aprovimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe procedurave të alokimit të mjeteve. Siç dihet, miratimi i buxhetit për këtë vit është bërë në fund të muajit mars. Ndërsa alokimi i mjeteve, si nga grandi ashtu edhe të hyrat e bartura, është bërë në fund të muajit prill. Po ashtu, disa projekte të rëndësishme në infrastrukturë nuk janë realizuar si rezultat i problemeve pronësore. Mungesa e të dhënave të sakta mbi pronën për shkak të mungesës së dokumentacionin që nga periudha e pasluftës, po bënë që shumë konteste pronësore të zgjasin për tu zgjidhur në gjykata. Komuna në disa prej këtyre rasteve ka filluar procedurat e shpronësimit kur pronësia ka qenë e qartë, ndërsa në rastet tjera lëndët janë proceduar në gjykata.

Tabela 8: Konsumi buxhetor sipas programeve krahasuar me buxhetin (%)

Përshkrimi	Administrata e Përgjithshme	Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	Arsim
Paga dhe Mëditje	105.78 *	131.26 *	135.86 *
Mallra dhe Shërbime	93.84	88.35	104.56 **
Shpenzime Komunale	86.14	98.82	96.05
Subvencione dhe Transfere	117.65 ****	98.96	-
Investime Kapitale	61.60	84.02	54.43
Gjithsej	69.32	110.32	111.42

Në vijim janë disa shpjegime për të dhënat e paraqitura në tabelën më lartë nur rastet kur ka pasur tejkalime të shpenzimeve mbi buxhetin e përcaktuar:

- * Tejkallimet në shpenzime për paga në administratë për 5.78%, në shëndetësi dhe mirëqenie sociale për 31.26% dhe në arsim për 35.86%, krahasuar me buxhetin e vitit 2011, është si rezultat i rritjes së pagave të të gjithë të punësuarve në sektorin publik që ka ndodhur nga muaji mars 2011, që në total është një rritje në kategorinë e pagave prej 4,475,176 €.
- ** Rritja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime për arsim për 4.56% mbi buxhetin përkatës ka ardhur si rezultat i mungesës së grantit për arsim nga ana e qeverisë për disa shpenzime të shkollave për mallra dhe shërbime. Komuna është dashur të

alokoi një pjesë të buxhetit të saj për mallra dhe shërbime nga administrata e përgjithshme në sektorin e arsimit.

*** Tejkalimi i shpenzimeve për subvencione për 17.65% krahasuar me buxhetin e përcaktuar për subvencione është si rezultat i një shume prej 200,000 € që ka pranuar komuna si ndihmë nga qeveria pas vëshimeve që kanë ndodhur në muajin maj në disa pjesë të Prishtinës dhe në zonat rurale.

d. Sektori për buxhet dhe financa

Në bazë të “Ligjit mbi menagjimin e financave publike dhe përgjegjësi” dhe “Ligjit për financat e pushtetit lokal”, aktivitetet që ka kryer ky sektor përfshijnë:

- Përgatitja e raporteve periodike financiare,
- Përgatitja e Pasqyrës Financiare për vitin 2011,
- Përgatitja e listës së projekteve për bartje të buxhetit në vitin 2011,
- Nënshkrimi i të gjithave pagesave-transaksioneve financiare,
- Zotimi i mjeteve dhe plotësimi i formularëve në sistemin Free Balanc,
- Pranimi dhe regjistrimi i faturave (obligim-pagesë),
- Kontimi i të gjitha urdhëresave në programin softverik,
- Regjistrimi i të hyrave nga inkasimi ditor (arka e taksave nr.01-233),
- Regjistrimi i të hyrave vetanake në sistemin Free Balanc dhe në programin softverik,
- Barazimet mujore me Departamentin e Thesarit-Ministria e Financave,
- Pranim-dorëzimi i parasë së imët në arkë dhe regjistrimi në ditarin e arkës 01-27,
- Pagesa e faturave të imëta me para të gatshme, nr.01-11,
- Kontimi dhe evidentimi i listës së të ardhurave personale nr.01-12,
- Plotësimi dhe ndryshimi i llogaritjes së të ardhurave personale-dërgimi në MAP,
- Alokimi i të hyrave dhe balancimi i tyre me shpenzimet,
- Përgatitja e procesit të rrjedhës së parasë,
- Përgatitja e Kornizës afatmesme buxhetore 2012-2014,
- Përgatitja e propozim buxhetit për vitin 2012,
- Regjistrimi i të dhënave buxhetore në programin BDMS dhe PiP,
- Ofrimi i të dhënave buxhetore për ekipin e auditimit dhe
- Punë të tjera sipas kërkesës së menaxhmentit.

e. Sektori i Tatimit në Pronë

Aktualisht Komuna e Prishtinës ka 69,863 obligues tatimor, prej tyre 59,860 janë obligues fizike dhe 10,003 janë obligues tatimor juridik. Në këtë vitë, është bërë modifikimi apo rianketimi i 1/3 së objekteve të regjistruara dhe si rezultat janë bërë 1,707 regjistrime të reja, 1,500 përmirësime, janë bërë shumë verifikime të adresave, numrit personal dhe zonave tatimore. Bordi i ankesave të tatimit në pronën e paluajtshme, gjatë vitit 2011, ka pranuar 816 ankesa për tatimin në pronë. Prej tyre janë aprovuar 675 kërkesa, ndërsa 141 janë refuzuar. Gjatë vitit është bërë vlerësimi i: 218 banesa, 115 shtëpive, 25 lokale afariste, 4 garazhe dhe 875 paluejtshmëri të tjera.

Gjatë vitit 2011, janë proceduar 2,866 lëndë të transaksioneve financiare të pronave bazuar në kontratat mbi shitje-blerje të vërtetuara në gjykata. Bazë për mbledhjen e tarifës komunale për këto raste ka qenë rregullorja për tarifa dhe ngarkesa. Janë lëshuar 9,644 vërtetime tatimore, prej tyre të përfunduara 8608 dhe të refuzuara 1036. Gjatë kësaj periudhe, janë inkasuar mjete në vlerë prej 441,250 euro në emër të taksës për regjistrimin e 44,500

automjeteve. Gjatë vitit përmes mediave të shkruara dhe elektronike është paralajmëruar për afatin e pagesës së tatimit në pronë. Gjithashtu është filluar me njoftim dhe bllokimin e llogarive bankare për personat fizikë dhe juridik, të cilët nuk kanë shpreh gatishmërinë e kryerjes së obligimeve tatimore ndaj komunës.

f. Sektori i Pronës

Gjatë vitit 2011, ky sektorë ka kryer detyra të punës nga fushë veprimi si: shqyrtimi dhe vendosja sipas kërkesave të personave fizik dhe juridik në procedurën Administrative nga lëmi i rregullimit të marrëdhënieve pronësore – juridike lidhur me pronën Komunale dhe pronën private kur kanë qenë të planifikuar me Plane Urbanistike për hapësira publike, zhvillimi i veprimtarive procedurale administrative sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës shoqërore dhe interesit tjetër Komunal dhe inicimin e proceduarave për implementimin e planeve urbanistike etj.

Ky sektor ka vepruar bazuar në kërkesat e palëve për uzurpimet e rrugëve dhe hapësirave tjera publike. Pas dëgjimit të palëve dhe shqyrtimit të provave, janë lëshuar 13 aktvendime për lirimin e pronave të uzurpuara. Pjesa tjetër e kërkesave ka qenë nga Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, e cila gjatë realizimit të projekteve ka hasur probleme në shtrirjen e trasesë së rrugëve. Zyrtarët e sektorit të pronës kanë dalë në vendngjarje dhe kanë filluar proceduarat e shpronësimit të pronave private të planifikuar për interes të përgjithshëm konform ligjit të shpronësimit. Janë shpronësuar 42 ngastra nëpër pjesë të ndryshme të qytetit, si: në lagjen Kalabria me rastin e ndërtimit të kolektorit atmosferik, ndërtimi i rrugës "B" në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1", projekti i rrugës "Enver Maloku" në kuadër të Planit Rregullues "Mati 1", projekti i rrugës "Dabishevcë-Hajkobillë" dhe shpronësimi i pronës për ndërtimin e rrugës "Aziz Zhilivoda".

Një pjesë të konsiderueshme të kërkesave janë nga Drejtoria e Arsimit si dhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e objekteve shkollore dhe atyre shëndetësore. Sektori i pronës ka siguruar lokacionet përkatëse për ndërtimin e këtyre objekteve, ka caktuar kufijtë e parcelave dhe ka përgatitur propozimvendimet për dhënie në shfrytëzim të këtyre lokacioneve. Gjatë vitit gjithashtu janë dërguar kërkesa nga institucionet qendrore: nga Qeveria 23 kërkesa, Gjykatat 11 kërkesa, nga Agjencioni Kosovar i Pronës 15 kërkesa, nga Agjencioni i Privatizimit 3 kërkesa, nga Agjencioni Kadastral 2 kërkesa, nga Instituti Sizmologjik 1 kërkesë, Ndërmarrjet Publike Qendrore 7 kërkesa, nga Bashkësia Islame 6 kërkesa dhe Agjencioni Kundër Korrupsionit 1 kërkesë. Këto kërkesa kanë qenë për ofrimin e provave dhe dokumentacion si dhe ofrimin e lokacioneve për ndërtimin e objekteve me interes të përgjithshëm. Një numër i kërkesave ka arritur edhe nga Gjykata Komunale, Hetuesia si dhe nga Avokatura Publike e Komunës. Natyra e kërkesave të këtyre institucioneve kryesisht ka qenë njoftimi për zhvillimet e procedurave si dhe është kërkuar nga Sektori i Pronës, verifikimin e origjinalitetit të dokumenteve të ndryshme si dhe format e procedurave të zhvilluara në nxjerrjen e këtyre dokumenteve.

Janë bërë kërkesa për kompensimin e paluejtshmërive të pronarëve privat të cilat parcela sipas planeve urbanistike janë paraparë për hapësira publike siq janë: rrugë, hapësira gjelbëruese, sheshe etj. Një pjesë e këtyre kërkesave kanë mbetur pa u realizuar për shkak se në pjesët e konsideruar të qytetit janë planifikuar Planet Urbanistike dhe shumë ngastra private janë paraparë për hapësira publike dhe se mundësit buxhetore për ti realizuar këto projekte nuk janë të mundshme brenda një viti. Andaj prioritet i është dhënë shpronësimit të

atyre ngastrave të cilave veç ka filluar ndërtimi i rrugëve, kurse pjesët tjera të ngastrave do të shpronësohen gradualisht me realizimin e Planeve Urbanistike ndërsa pronarët privatë vazhdojnë të shfrytëzojnë ngastrat e planifikuara për hapësire publike në të njejtin destinacion sikur i kanë pasur para miratimit të Planeve Urbanistike.

Për implementimin e Planeve Urbanistike, sektori i pronës është bazuar në Vendimi me 01/400-660, dt. 26.05.2008, ku është paraparë mënyra e kompensimit në etazhitet bazuar në marrëveshjen me pronarët privat për kompensimin e pjesëve të ngastrave të parapara për hapësira publike. Këto ngastra janë kryesisht të parapara për rrugë bazuar në Planet Urbanistike. Kërkesat të cilat nuk kemi mundur që të zhvillojmë procedura kanë qenë kërkesat për de-eksprijim (kthimit të tokave ish pronarëve). Këto kërkesa janë adresuar në instanca të tjera pasi ka qenë e mundur të shqyrtohen për shkak të mungesës së dokumentacionit lidhur me atë se si është kryer eksprijimi në të kaluarën dhe se a janë kompensuar pronarët për pronat e eksprijuara.

9. DREJTORIA E EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT

a. Sektori i Ekonomisë

Gjatë vitit 2011, janë kryer 7,380 lëndë, prej tyre 2,150 leje pune për subjekte afariste dhe 5,230 vërtetime, kërkesa dhe njoftime. Realizimi i të hyrave nga biznesi ka arritur në 450,984 € apo 75% e planifikimit. Në mos përmbushjen e këtij zëri buxhetor ka ndikuar në masë të madhe kriza ekonomike gjatë vitit 2011, numri i vogël i inspektorëve të tregut, mos përputhja e adresave të bizneseve gjatë fazës së regjistrimit të tyre si dhe dilemat e paraqitura pas amendamentimit të ligjit mbi shoqëritë tregtare lidhur me lëshimin e lejeve të punës.

Në sektorin e transportit të udhëtarëve me auto-taksi janë bërë ndryshime cilësore duke zbatuar rregulloren komunale me qëllim që qytetarëve tu ofrohet siguri dhe transparencë përmes vendosjes së shenjave identifikuese mbi auto-vetura. Në vazhden e projekteve për zvogëlimin e papunësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim me zyrën regjionale të punësimit ka realizuar projektin “Trajnimi i të rinjve në punë në ndërmarrësi”. Janë trajnuar 30 të rinjë duke i vendosur nëpër biznese për një periudhë 6 mujore dhe janë paguar nga 130 € në muaj. Në bashkëpunim me MTI, janë përzgjedhur 5 biznes plane më të mira dhe biznes plani më i mirë është stimuluar me 1,000 € nga Komuna e Prishtinës. Komuna ka shpenzuar një shumë prej 23,400 € në projekte për zvogëlimin e papunësisë përmes trajnimit të të rinjve dhe mbështetje të tyre për hapje të bizneseve. Komuna e Prishtinës është përfituese e projektit “One-Stop-Shop” nga Komisioni Evropian. Ky projekt është shumë i rëndësishëm për komunitetin e biznesit. Deri më tani janë trajnuar mbi 100 biznese ekzistuese dhe fillestare. Njëkohësisht është bërë edhe trajnimi i stafit të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim për ofrimin e shërbimeve për regjistrimin e bizneseve, pasi pritet delegimi i kompetencave nga MTI në Komunë. Ky delegim i shërbimit të regjistrimit të bizneseve është dashur të bëhet që nga viti 2010.

b. Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim rural

Gjatë vitit 2011, ky sektor përcjell punët dhe zhvillimet në lëmin e bujqësisë si: procesi i mbjelljeve pranverore, procesi i korrje-shirjeve, këshillime profesionale të fermerëve, procesi i mbjelljeve vjeshtore etj. Në lëmin e pylltarisë, pas bartjes së kompetencave në komunë, aktivitet kryesor ka qenë ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, erozioni fizik etj. Po ashtu, është bërë damkosja (në stivë) e masës drusore që është e lejuar për

shfrytëzim. Në tabelën në vijim janë paraqitur projektet e realizuara dhe vlerat e tyre. Në total, Komuna e Prishtinës ka shpenzuar 427,164 € për të mbështetur zhvillimin bujqësor.

Tabela 9: Projektet, subvencionet dhe aktivitetet e realizuara

Nr.	Projektet në fushën e bujqësisë	Vlera / €
1.	Subvencionimi i fermerëve për mbjelljet pranverore	49,925
2.	Furnizimi me serra dhe fidanë të specave dhe domateve	36,538
3.	Veterina mobile	23,860
4.	Furnizimi me mështjerra barëse	27,440
5.	Këshillime profesionale të fermerëve *	---
6.	Procesi i korrije-shirjeve *	---
7.	Trajnimet në pemëtari dhe furnizimi me fidanë të pemëve	87,586
8.	Furnizimi me makina mjelëse	39,840
9.	Meliorimi i livadheve dhe kullosave	29,475
10.	Furnizimi me pajisje bletare	32,500
11.	Subvencionimi i fermerëve për mbjellje vjeshtore	100,000
	Total	427,164

* Për aktivitetin (5) dhe (6) komuna nuk ka shpenzuar mjete financiare, por i ka mbështetur bujqit me këshillime profesionale nga stafi komunal.

Realizimi i mbjelljeve pranverore: Bazuar në programin e të mbjellave pranverore për vitin 2011, në Komunën e Prishtinës janë mbjellë gjithsej 1,310 ha me kultura pranverore. Tabela në vijim tregon kulturat e mbjella, ku mbizotëron kultura e misrit me 60% të sipërfaqeve të mbjella pranverore.

Tabela 10: Sipërfaqet e mbjella me kultura pranverore

Nr.	Kultura	Sipërfaqe/ha	%
1.	Tërshërë	68	5%
2.	Misër	780	60%
3.	Bimë foragjere	22	2%
4.	Patate	353	27%
5.	Perime	49	4%
6.	Fasule si monokulturë	19	1%
7.	Elb pranveror	19	1%
	Total	1,310	100%

Subvencionimi i fermerëve për mbjelljet pranverore: Me qëllim të përkrahjes së fermerëve dhe rritjes së sipërfaqeve me kultura pranverore, Komuna e Prishtinës ka bërë subvencionimin e 134 fermerëve për mbjelljet pranverore me misër dhe patate në tri kategori:

- kategoria e I-rë në shumën prej 193 € (1 ha misër),
- kategoria e II-të në shumën prej 386 € (2 ha misër) dhe
- kategoria e III-të në shumën prej 600 € (2 ha patate).

Furnizimi me serra dhe fidanë: Me projektin e furnizimit me serra dhe fidanë janë përkrahur 250 fermerë me nga një serrë në sipërfaqe prej 54 m², si dhe me nga 100 fidanë (70 spec dhe 30 domate).

Veterina mobile: Me qëllim të parandalimit të paraqitjes së sëmundjeve infektive është bërë vaksinimi i gjithsej 4,382 gjedheve dhe 622 qenve si dhe mbarësimi artificial i 968 gjedheve.

Furnizimi me mështjerra barëse: Furnizimi me mështjerra barëse është realizuar me bashkëfinancim me shoqatën “Heifer International Kosova”, ku kanë përfutuar 20 familje të

fshatrave Prugoc dhe Barilevë nga një mështjerrë barëse të racës “Simental”. Komuna ka participuar me mjete në vlerë prej 27,440 €.

Këshillime profesionale të fermerëve: Në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit rural është realizuar projekti “Dhënia e këshillave fermerëve”, ku janë dhënë këshilla fermerëve të tri kategorive: fermerëve ekzistencial, fermerëve gjysmë komercial dhe fermerëve komercial.

Procesi i korrje-shirjeve: Ky proces ka filluar me datë 15/07/2011 dhe kanë përfunduar me datë 11/08/2011. Kanë marrë pjesë 34 autokombajna, të cilat kanë përfituar subvencionin në derivate të naftës në sasi prej 1,000 litra/autokombajnë nga ana e MBPZHR në bazë të marrëveshjes që MBPZHR ka bërë me komuna dhe auto-kombanjer. Çmimi i korrjes është sjell rreth 100 €/ha pa lidhëse. Sipërfaqet e përgjithshme të mbjella me drithëra të bardha kanë qenë 1,348 ha prej tyre: grurë 1,250 ha, tërshërë 76 ha dhe elb 22 ha. Rendimentet e grurit dhe cilësia e tij ishin të mira dhe silleshin mesatarisht 4,100 kg/ha, rendimenti i elbit sillej rreth 3,300 kg/ha, ndërsa i tërshërës 2,900 kg/ha. Krahasuar me vitin paraprak, sipërfaqet e mbjella me drithëra të bardha kanë qenë më të vogla, mirëpo rendimentet kanë qenë më të larta për 20%.

Trajnimet në pemëtari dhe furnizimi me fidan të pemëve: Janë realizuar trajnime në pemëtari për përfituesit e projektit “Furnizimi me fidane të pemëve”. Kanë përfituar 65 fermer nga 450 fidane të pemëve (tre varietete të mollës dhe një varietet të kumbullës) për mbjelljen e një sipërfaqeje prej 0.50 ha.

Furnizimi me makina mjelëse: Kanë përfituar 160 fermer, në përzgjedhjen e të cilëve si kriter ka qenë numri prej 4 e më shumë krerë të gjedheve qumështore për një fermer.

Meliorimi i livadheve dhe kullosave: Me qëllim të sigurimit të ushqimit foragjer cilësor për kafshë është bërë furnizimi i 126 fermerëve me farë bari cilësor dhe pleh mineral për mbjelljen e 1 ha/fermer. Gjithsej janë mbjell 126 ha me bimë foragjere.

Furnizimi me pajisje bletare: Pajisje bletare kanë përfituar 100 bletarë në fazën e parë, ndërsa në fazën e dytë të njëjtë do të përfitojnë nga dy bletë.

Realizimi i mbjelljeve vjeshtore: Procesi i mbjelljeve është realizuar sipas planifikimeve dhe kushtet klimatike kanë qenë të volitshme për mbjelljen e kulturave vjeshtore. Në bazë të të dhënave që ne kemi siguruar, në këtë vit janë mbjell gjithsej 1,475 hektarë, prej të cilave 1,345 ha grurë dhe 130 hektarë bimë foragjere. Komuna ka subvencionuar fermerët për mbjelljet vjeshtore me një shumë prej 100,000 €, ku kanë përfituar 393 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme 640 ha. Komuna ka paguar subvencione prej 156 € për mbjelljen e një hektari.

c. Sektori i pylltarisë

Kompetencat për menaxhimin e pyjeve të Komunës së Prishtinës janë bartur nga niveli qendror në komunë gjatë vitit 2010. Gjendja në të cilën komuna i ka marrë nën menaxhim pyjet ka qenë jo e kënaqshme. Gjatë vitit 2011, janë konfiskuar masa drusore ilegale nga prerësit ilegal në sasi prej 178 m³, të cilat komuna i ka shpërndarë për kategori të ndryshme si shoqatave të dala nga lufta dhe rasteve sociale (në sasi prej 103 m³). Pjesa e mbetur prej 75 m³ gjenden në depo. Gjatë këtij viti janë mbjell 5 hektar me fidane të llojit të pishës. Janë

shqiptuar dhe iniciuar fletëparaqitje për prerësit ilegal të pyjeve, prej të cilëve në gjykatën për kundërvajtje janë iniciuar 50 raste dhe në gjykatën penale 91 raste. Sektori i pylltarisë ka pranuar 165 kërkesa për prerje në pyjet private, prej të cilave janë realizuar dhe paguar 135 kërkesa.

10. DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUNMM) përbëhet nga sektorët e Planifikimit, Urbanizmit, Ndërtimit, Legalizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Fushë veprimtaria dhe punët e kësaj drejtorie kryesisht janë bazuar në planifikimin e hapësirës në tërë territorin e komunës, kontrollimin dhe mbikëqyrjen e ndërtimeve në terren, mbrojtjes së mjedisit, trajtimin e ndërtimeve ilegale si dhe në plotësimin e kërkesave të qytetarëve nga sfera e urbanizmit ndërtimit dhe mbrojtjen e mjedisit. Për lokacionet e caktuara për ndërtimin e objekteve për të cilat ka qenë investitor komuna, është përgatitur i tërë dokumentacioni tekniko-investigativ, detyrat dhe programet projektuese për shpalljen e tenderëve, është marrë pjesë në komisionet për vlerësimin e dokumentacionit të ofertave, si dhe është bërë menaxhimi i realizimit-ndërtimit i këtyre objekteve nga personeli profesional i kësaj drejtorie.

a. Sektori i urbanizmit

Sektori i urbanizmit kryesisht është marrë me shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me caktim të lokacioneve, kushtet e lokacionit, caktimin e kushteve urbanistike-teknike, lejeve ndërtimore, lejeve paraprake, leje për rrënimin e objekteve, leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese. Janë hartuar konkluzione për miratimin e projekteve urbo-arkitektonike dhe atyre ideore për zona përkatëse. Janë shqyrtuar ankesat e qytetarëve të natyrave të ndryshme etj. Ky sektor, gjatë vitit 2011, ka shqyrtuar 1,756 lëndë të paraqitura në tabelën në vijim..

Tabela 11: Kërkesat e pranuar dhe trajtimi i tyre gjatë vitit 2011

Nr.	Përshkrimi	Gjithsej	%
1.	Numri i lejeve urbanistike	241	13.7
2.	Numri i lejeve të ndërtimit	91	5.2
3.	Refuzime	91	5.2
4.	Informime	768	43.7
5.	Njoftime	22	1.3
6.	Leje paraprake	9	0.5
7.	Konkluzione	30	1.7
8.	Leje rrënimi	2	0.1
9.	Leje përdorimi	108	6.2
10.	Të miratuara (akte përcjellëse, pëlqime, caktim i pikave etj.)	117	6.7
11.	Lëndë në procedurë	277	15.8
	Gjithsej	1,756	100.0

b. Sektori i planifikimit

Sektori i planifikimit ka qenë i angazhuar në përgatitjen, koordinimin dhe qasjen në hartimin e planeve rregulluese, përgatitjen e detyrave programore, të materialit tenderues për planet rregulluese, përgatitjen e metodologjisë së mbajtjes së punëtorive dhe mbajtjen e prezantimeve si dhe përgatitjen dhe mbajtjen e diskutimeve publike për planet përkatëse rregulluese. Prioritet i veçantë i është dhënë përfundimit të hartimit të planeve rregulluese: Zona Ekonomike, Vellusha dhe Medreasa-Çamëria. Lidhur me këto plane janë mbajtur edhe

një numër i konsiderueshëm i punëtorive me kompanitë të cilat janë angazhuar për hartimin e këtyre projekteve. Në pajtim me dispozitat ligjore, janë organizuar edhe takime me qytetarë si konsultime urbane dhe diskutime publike. Gjithashtu për shumë lagje janë mbajtur takime konsultative lidhur me projektet urbo-arkitektonike.

Në bazë të detyrave projektuese, në fazën e tenderimit janë këto plane urbane dhe projekte:

- Plani Zhvillimor Komunal
- Plani Zhvillimor Urban
- Prishtina e Re me tri zona:
 - o Zona perëndimore
 - o Zona qendrore
 - o Zona lindore.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave dhe Pronës janë mbajtur punëtori me grupe punuese për krijimin e kushteve për realizimin e rrugës “Enver Maloku” në lagjen “Mati 1” dhe për lagjen Kalabri për ndërtimin e kolektorit. Është caktuar lokacioni dhe është hartuar projekti për WC publike në Gërmi dhe Taukbahe. Është hartuar detyra projektuese për plotësimin dhe ndryshimin e Planit Rregullues “Kalabria”.

c. Sektori i ndërtimit

Ky sektor në bazë të detyrave programore, kryesisht është marrë me përpunimin e lëndëve të ndërtimit, hartimin e detyrave projektuese, mbikëqyrjen e objekteve, formimin komisioneve profesionale, caktimin e komisioneve për pranimin teknik të objekteve, dhënien e lejeve për përdorim të objekteve si dhe veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me këtë sektor. Janë përpunuar lëndët që kanë të bëjnë me: lejet e përdorimit, pranimet teknike, gjendjen ekzistuese të objekteve dhe përgatitjen e preventivës së nevojshme, informimin e qytetarëve lidhur me infrastrukturën e planifikuar, problemet e stabilitetit të objekteve si dhe me planifikimin e infrastrukturës. Gjatë kësaj periudhe raportuese ky sektor është marrë me përgatitjen detyrave projektuese për shumë rrugë në lagjet e urbanizuara.

Sektor i ndërtimit gjithashtu gjatë kësaj periudhe raportuese ka bërë mbikëqyrjen e projektimit dhe ndërtimin e objekteve të larta dhe të ulëta, të dhëna në vijim:

- Objektet e ndërtimit të lartë
 - o Fasadimi i objekteve ne qytet
 - o Fasadimi dhe renovimi i objektit të Komunës
 - o Ndërtimi i shkollës në Hajvali;
 - o Ndërtimi i shkollës Arbëri;
 - o Ndërtimi i Bibliotekës së Qytetit;
 - o Objekti i Zjarrfikësve;
 - o Tereni sportiv në Kodrën e Diellit;
 - o Salla e edukatës fizike dhe aneksit në SHF ”M. Bajraktari”;
 - o Objekti i banimit për Invalidët dhe Veteranët e UÇK;
 - o Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore “Meto Bajraktari”;
 - o Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore “7 Marsi”;
 - o Ndërtimi i aneksit dhe sallës së SHM “Sami Frashëri”;
 - o Ndërtimi i Objektit të Shkollës në Llajshevc;
 - o Ndërtimi i QMF në lagjen Medreseja;
 - o Ndërtimi i Objektit të Shkollës Ekonomike
 - o Ndërtimi i wc publike në Gërmi

- Kompletimi i një kati te QMF ne Arberi
- Objektet e ndërtimit të ulët në bashkëpunim me DIL
 - Rrugët – infrastruktura komunale:
 - Rruga B në lagjen “Mati 1”;
 - Rruga mbi kolektorin atmosferik të lumit Prishtina; ne Kalabri
 - Rregullimi i fontanës te komuna
 - Rikonstruimi i rrugës UÇK dhe Fehmi Agani
 - Fasadimi i objekteve ne rrugën: Agim Ramadani, Luan Haradinaj, UÇK, Rexhep luci, Qamil Hoxha, Fehmi Agani dhe rrugën „ Tringe Smajli” .
 - Rruga “ Ekrem Rexha” ne lagjen “Arberia3”
 - Ndërtimi i rrugës Prishtinë Shkabaj
 - Sanimi i rrafshit rrëshqitës ne Arbëri
- Mbikëqyrja dhe koordinimi i projekteve për infrastrukturë në bashkëpunim me DIL
 - Projektimi i unazës së brendshme ,pjesa lindje dhe perëndim, projektimin e rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore për lagjet e urbanizuara (Arbëri 3, Mati 1, Lakërishte),
 - Projektimin rrugëve dhe infrastrukturës nëntokësore për rrugët e lagjeve të pa urbanizuara dhe fshatrave;
 - Komisione profesionale për vlerësimin e objekteve;
 - komisione për hapjen dhe vlerësimet e tenderëve të organizuar nga zyra a prokurimit të komunës
 - komisione për pranime teknike
 - Janë lëshuar Vërtetime për dëmet e objekteve nga pasojat e luftës, etj.
 - Janë dhënë leje të përdorimit: për objekte familjare 100 leje, për Fshatin Ndërkombtarë, për objekte kolektive 6 leje dh për shëndrrime 2 leje

d. Sektori i mbrojtjes së mjedisit

Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit së Prishtinës ka kryer punë në pajtim me detyrat programore duke u mbështet në dispozitat ligjore të aplikueshme, rregulloret dhe vendimet e Kuvendit Komunal, ka bërë njoftime në lidhje me mbrojtjen e ambientit (tokës, ujit dhe ajrit) siç janë: kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, trotualet, ujërat e zeza si dhe zhurma e shkaktuar nëpër lokale afariste nga gjeneratorët. Sektori përballet me mungesë të stafit.

Në bashkëpunim me Komisionin Evropian është bërë “Plani strategjik për ujëra të zeza dhe kanalizim”. Në bashkëpunim me GIZ dhe kompaninë Rajonale Pastrimi është përgatitur “Plani Lokal i Veprimt për Administrimin e Mbeturinave”, i cili do të pilotohet në një lagje të Prishtinës me mbështetje të GIZ-it gjerman. Është përgatitur detyra projektuese për deponinë e mbeturinave, është shënuar ditën botërore të ujit, është shënuar dita botërore e tokës përmes mbjelljes së filaneve në disa lokacione në qytet dhe janë vendosur disa shporta për mbeturina në disa shkolla të komunës të dhuruara nga Agjensioni Rajonal për Zhvillim. Po ashtu, është shënuar dita botërore e mjedisit, janë organizuar punëtori mbi mjedisin në bashkëpunim me Zyrën Japonece (JICA) si dhe është punuar plani investiv për ujësjellës dhe kanalizim. Është bashkëpunuar ngushtë edhe me shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare, si Qendra Rajonale për Mbrojtjen e Mjedisit (REC) për implementimin e Konventës Aarhus në Kosovë mbi ngritjen e kapaciteteve për qeverisje më të mirë mjedisore.

Janë pranuar disa ankesa sa u përket tejkalimit të vlerave të lejuara të zhurmës nga lokalet e ndryshme. Në bashkëpunim me zyrtarë të shërbimeve publike dhe inspektoratit mjedisor

është intervenuar duke përdorur aparatën për matjen e zhurmës. Është hartuar edhe projekti për matjen dhe monitorimin e zhurmës në Komunën e Prishtinës dhe projekti për vetëdijesim mjedisor, të cilat projekte pritet të implementohet gjatë vitit 2012.

e. Sektori i legalizimit

Gjatë kësaj periudhe, ka vazhduar trajtimi i 6,156 lëndëve për legalizimi të pranuar gjatë periudhës 1 shtator - 31 dhjetor të vitit 2010. Prej tyre, në përputhje me rregulloren për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe manualin e legalizimeve, janë lëshuar 30 leje të legalizimit për objekte të ndërtuara pa leje, janë caktuar 180 kushte urbanistiko-teknike për hartimin e dokumentacionit-projekteve për objektet e zbatuara me elaboratet përkatëse që janë në procedurën e dhënies së pëlqimit. Numri i lëndëve që janë refuzuar është 10, të cilat janë kryesisht raste të ndërtimeve në hapësira publike. Po ashtu, në 780 raste gjatë shqyrtimit të kësaj kategorie të kërkesave, janë lëshuar informime dhe kërkesa për plotësim e lëndëve, konkluzione për pezullimin e përhoshëm të procedurës etj.

11. DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS LOKALE

Drejtorja për Infrastrukturën Lokale ka kryer këto aktivitete: hartimi i detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave, shqyrtimi i kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimi i tyre në planet e komunës, njoftimi me kohë i kompanive publike dhe subjekteve relevante me qëllim të koordinimit të punëve, incizimi i gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, hartimi i paramasave dhe parallogarive si dhe kompletimi i dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrja e realizimit të projekteve konform marrëveshjes etj

a. Vëllimi financiar dhe fizik i projekteve të realizuara

Në vitin 2011, vlera kontraktuese e punimeve është 20,265,232 €, ndërsa janë shpenzuar 16,224,391 € ose 80%. Në vijim është dhënë vëllimi fizik i projekteve të realizuara:

- Rrugë të ndërtuara me asfalt dhe pllaka	89,688 metra gjatësi
- Sipërfaqe të asfaltuara	624,834 metra katrorë
- Trotualet	106,789 metra katrorë
- Sipërfaqe të ndërtuara me pllaka	108,795 metra katrorë
- Kanalizime fekale	39,688 metra gjatësi
- Kanalizime atmosferike	12,168 metra gjatësi
- Rrjeti i ujësjellësit	12,647 metra gjatësi

b. Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese

Duke marrë për bazë ligjin mbi planifikimin hapësinorë, ligjin mbi ndërtimin e objekteve investive si dhe ligjin për projektim e në veçanti planet rregullative, janë hartuar detyrat projektuese për këto rrugë në zonat urbane.

Tabela 12: Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese për zonën urbane

Nr.	Detyra projektuese	Përshkrimi i punëve ndërtimore
1.	Hartimi i projektit kryesor për rr.A dhe në lagjen Mati I	Rruga, kanalizimi, ndriçimi
2.	Hartimi i projektit kryesor për rr.Trepca, rr,Muharem Fejza dhe rr.Naser Hajrizi	Rruga, ndriçimi

3.	Hartimi i projektit urbo-arkitektonik të Sheshit të Pavarësisë "Ibrahim Rugova "	Rruga, kanalizimi, ndriçimi
4.	Hartimin e projektit kryesor të rrugës në Sofali dhe kanalizimit fekal prej fshatit Shkabaj në drejtim të lagjës "Arbëria" dhe lagjes Kodra e Trimave	Rruga, kanalizimi, ndriçimi
5.	Hartimi i projektit urbo-arkitektonik të Sheshit "Zahir Pajaziti"	Rruga, kanalizimi, ndriçimi

Po ashtu janë kryer detyra projektuese edhe për këto rrugë rurale.

Tabela 13: Hartimi i projekteve dhe detyrave projektuese për zonën rurale

Nr.	Detyra projektuese	Përshkimi i punëve
1.	Hartimi i projektit zbatues për rrugët rurale në Grashticë, Keqekollë dhe Marec	Asfaltim
2.	Hartimi i projektit kryesor për rrugën Viti e Marecit – Cukë	Asfaltim

Gjatë hartimit të projekteve nga kompanitë fituese të tenderit është kërkuar që këto kompani të kenë kontakte të vazhdueshme me drejtoritë komunala dhe kompanitë publike për përgatitjen e varianteve më të volitshme për projektimin e instalimeve nëntokësore

c. Hartimi i projekteve për ofertim

Duke u bazuar në kërkesat e shumta të qytetarëve për rregullimin urgjent të infrastrukturës rrugore në lagjet e tyre dhe domosdoshmëria e intervenimit, ekipi teknik hartoi këto projekte:

2. Rindërtimi i krahëve të rr. Muharrem Fejza, rr. Isa Kastrati dhe disa rrugë të tjera në lagjen Mat,
3. Rindërtimi i rr. Tutini, rr. Aziz Zhilivoda dhe rr. Mustafë Hoxha,
4. Rindërtimi i rr. Ismet Asllani, rr. Vllezerit Maqastena, rr. Ismet Rraci dhe disa rrugë në lagjen Arbëria dhe Qameria,
5. Riparimi i gropave në rrugët e qytetit,
6. Rregullimi i fontanës të objekti i vjetër i Komunës së Prishtinës,
7. Rindërtimi i disa rrugëve në lagjen Kodra e Trimave,
8. Ndërtimi i kolektorit dhe rrugës mbi lumin Mat në Kalabri dhe disa rrugë në lagjen Kalabri,
9. Kanalizimi në qendrën kulturore të fëmijëve në Gërmi,
10. Rindërtimi i krahëve të rrugës në lagjet Sheshi i Arbërit, Tabet e Llapashticës dhe disa rrugë në lagjen Kodra e Trimave,
11. Rindërtimi i rr. Rustem Statovci,
12. Rindërtimi i disa rrugëve në lagjet Arbëria, Velani dhe Sofali,
13. Rindërtimi i rrugëve lidhëse me rr. Vellezirit Fazliu dhe rr. Isa Kastrati,
14. Rindërtimi i disa rrugëve në lagjet Kalabri, Taslixhe dhe Ilirida,
15. Rindërtimin dhe asfaltimin e rrugëve në Hajvali, Ballaban dhe Prapashticë,
16. Ndërtimi i kanalizimit në rr. Haki Tahaj,
17. Kanalizimet të Tjegullorja,
18. Rregullimi i platosë të ndërmarrja komunale "Pastrimi",
19. Sanimi i rr. Dëshmorët e Marevcit, rr. Bedri Shala dhe parkingu prapa rr. Robert Doll,
20. Ndërtimi i rrugës dhe kanalizimit në fshatin Prugovc,
21. Asfaltimi i rrugëve në Tenezhdoll, Vranidoll dhe Bardhosh,
22. Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në Hajvali,
23. Ndërtimi i disa rrugëve dhe kanalizimeve në fshatin Lukar dhe Makovc,
24. Rregullimi i rrugës në Ulpianë, trotualet në rr. Iljaz Kodra, rr. Martin Camaj, krahët e rr. Xhavit Ahmeti dhe rrugës në Veternik,

25. Ndërtimi i mureve mbrojtëse të disa rrugëve të Prishtinës,
 26. Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rr.Tomori, rr.Tutini, rr. 27 Nëntori, në Keqekollë-Kaqot.

d. Projektet infrastrukturore gjatë vitit 2011

Kontratat e reja te vitit 2011 në infrastrukturën rrugore janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 14: Projektet të kontraktuara për vitin 2011

1	Ndërtimi i rrugës Rimanisht Siqevë - faza e parë
2	Rindërtimi i rr.UÇK dhe Fehmi Agani
3	Rindërtimi i kraheve te rr. Muharem Fejza, Isa Kastrati dhe disa rr.tjera ne lagjen Mate
4	Rindërtimi i rr. Tutini, Aziz Zhilivoda dhe Mustaf hoxha
5	Ndërtimi I rruges Tomori
6	Rindërtimi i rr.Ismet Asllani, Vllezerit Maqastena Ismet raci dhe disa rrugëve. Ne lagjen Arberia dhe Qameria
7	Riparimi i gropave ne rruget e qytetit
8	Rregullimi i fontanës te objekti i vjeter i Komunës së Prishtines
9	Ndërtimi I kolektorit dhe rr.mbi lumin Mat në Kalabri kanalizimin në qendren Kulturore te femijeve ne Germi dhe disa rrugeve ne lagjen Kalabri
10	Rindërtimi i disa rr. ne lagjen Kodra e Trimave
11	Rindërtimi i rr. Nue Perlleshi nga rr. Muharem Fejza deri te qendra e mjekesisë familjare Mati 1
12	Rindërtimi I kraheve te rr. ne lagjet Sheshi I Arberit, Tabet e Llapashtices dhe disa rr. Ne Kodren e trimave
13	Rindërtimi i rruges Rrustem Statovci
14	Rindërtimi i disa rrugeve ne lagjen Arberia , Velani dhe Sofali
15	Rindërtimi i rr. Lidhese me rr. Vellezirit Fazliu dhe Isa Kastrati
16	Rindërtimi i disa rr. Ne lagjet Kalabri, Taslixhe, dhe Ilirida
17	Rindërtimin dhe asfaltimin e rr. ne Hajvali, Ballaban dhe Prapashtice
18	Sanimi i rr. Deshmoret e marevcit, Bedri Shala dhe parkingu prapa rr. Robert Doll
19	Ndërtimi i rruges " B " faza e dyte
20	Ndërtimi i rruges " Ekrem Rexha "
21	Ndërtimi i nënkalimit për këmbësor te " Xhamia e Llapit "
22	Ndërtimi i kanalizimit ne rr. "Haki Tahaj " kanalizimet te tjegullorja dhe rregullimi I platose te ndermarja komunale "Pastrimi"
23	Ndërtimi i rruges "B" faza e katert
24	Ndërtimi i rr. "Ahmet Krasniqi "
25	Ndërtimi I rruges " Ibrahim Fehmiu "
26	Ndërtimi I rruges dhe kanalizimit ne fshatin Prugovc
27	Asfaltimi i rrugeve ne Tenezhdoll, Vranidoll dhe Bardhosh
28	Asfaltimi i rruges ne lagjen " Kaqot " ne Keqekolle
29	Ndërtimi i rrugeve dhe kanalizimeve ne Hajvali
30	Ndërtimi I rruges ne fshatin Barilevë
31	Ndërtimi i disa rrugeve dhe kanalizimeve ne fshatin Lukar dhe Makovc
32	Asfaltimi I rrugeve Sunidoll - Bernicë (faza e pare)
33	Sanimi I disa rrugeve ne qytet dhe fshatra ne K.prishtines
34	Ndërtimi I rrugeve Slivovë-Busi-Llajshec
35	Ndërtimi I rruges Qemal Stafa
36	Rregullimi I rruges ne Ulpiane,trotuaret ne rrugen Iljaz Kodra,rruges,,Martin Camaj" krahët e rruges Khavit Ahmeti dhe rruges ne Veternik

37	Rregullimi I kolektorit ne proin Vellusha ne Taukbahqe
38	Ndertimi I kanalizimit dhe ujesjellsit ne rruget "Haxhi Zeka dhe Ndue Pertleshi
39	Ndertimi i rruges " Tahir Zajmi"
40	Asfaltimi I rruges " Shpetim Robaj ne Germi
41	Ndertimi I mureve mbrojtese te disa rrugeve te Prishtines
42	Sanimi rrafshit rreshqites ne Arberi
43	Ndertimi i rrugeve Flotacion - Lagja Vrajolle
44	Ndertimi i rruges ne Mramor - lagja Spahiaj
45	Ndertimi i rruges Viti Bullaj
46	Rregullimi i kolektorit nga rruga " Abedin Rexha derI te rruga " Ibrahim Fehmiu "
47	Zgjerimi I rruges per skaj Ambasades Amerikane
48	Ndertimi i mureve mbrojtese në rrugen Tomori, Tutini 27 Nentori , Keqekolle – Kaqot
49	Hartimi i projektit kryesor per rr. A dhe ne lagjen Mati I
50	Hartimi i projektit kryesor te rr.Trepca , Muharem Fejza dhe Naser Hajrizi
51	Hartimi I projektit Urbo-Arkitetikonik të Sheshit të Pavarësisë " Ibrahim Rugova "
52	Hartimi I projektit zbatues për rrugët rurale në Grashticë, Keqekollë dhe Marec
53	Hartimi I projektit kryesor për rrugen Viti e Marecit –Cukë
54	Hartimin e projektit kryesor të rrugës në Sofali dhe kanalizimit fekal prej fshatit Shkabaj në drejtim të lagjës "Arberi " dhe Kodra e Trimave
55	Hartimi I projektit kryesor të rrugeve "Trepça " Muharrem Fejza , "dhe Naser Hajrizi
56	Hartimi I projektit Urbo-Arkitetikonik të Sheshit të Zahir Pajaziti

e. Projektet infrastrukturore të vitit 2010 të përfunduara në vitin 2011

Në vijim është lista e projekteve të bartura nga vitit 2010 që janë kryer gjatë vitit 2011, me përjashtim të projektit numër gjashtë të rr.Enver Maloku (arsyet për mos kryerjen e kësaj rruge janë kryesisht të natyrës pronësore). Shuma e mjeteve të shpenzuara në projekte të vitit 2010 të përcjella në vitin 2011 është 4,485,417 €.

Tabela 15: Projektet e bartura nga 2010 që janë kryer gjatë vitit 2011

Nr	Emri i projektit	Statusi
1.	Rindertimi i rruges Hilmi Rakovica	Përfunduar
2.	Ndertimi i rrugeve lidhese me rrugët Vellezerit Vazliu	përfunduar
3	Muharrem Fejza	Përfunduar
4.	Ndërtimi i kanalizimit fekal në Bërnice e ulët	Përfunduar
5.	Ndërtimi i rrugës Agim Ramadani	Përfunduar
6.	Ndërtimi i vazhdimit të rrugës Enver Maloku	I Pa Përfunduar
7.	Ndërtimi i vazhdimit të rrugës Hyzri Talla	Përfunduar
8	Sanimi i rrugëve Bajram Bahtiri , Mic Siokoli	Përfunduar
9.	Ndërtimi I kanalizimit dhe rrugës mbrapa shkolles Gjin Gazulli	Përfunduar
10.	Rindertimi I rrugëve te Medresa në Prishtinë	Përfunduar
11	Rindertimi I rrugëve në lagjen Kalabria	Përfunduar
12	Ndertimi I kolektorit atmosferik mbi lumin Prishtina	Përfunduar
13	Ndertimi I rruges ne Lebane dhe kanalizimi fekal ne Prugovc	Përfunduar
14	Rregullimi I rruges dhe platos rreth Stadiumit Futbollistik	Përfunduar
15	Vazhdimi i rruges Hollgen Petersen	Përfunduar
16	Rindertimi I rruges „Mbreti Longar"	Përfunduar
17	Ndertimi I rruges „Gjergj Balsha"	Përfunduar
18	Rruga Leka I Madhë dhe muri mbrojtës Deme Ahmeti	Përfunduar
19	Rruget Hoxhë Tahsini, Ismet Jashari , Nikolla Teslla, Hill Mosi	Përfunduar
20	Kanalizimi fekal,„Shkabaj" dhe muret	Përfunduar
21	Sanimi I rrugeve te qytetit +kanalizimet	Përfunduar
22	Riparimi I rruges lidhese Grashtic-Mramor	Përfunduar
23	Rindertimi I rrugeve Skender Anamali, Peshteri Pashtriku dhe Nazim	Përfunduar

24	Asfaltimi I rrugëve Dheu I kuq-Gllogovicë-Dabishevc-Hajkobillë	Përfunduar
25	Ndërtimi I kanalizimit ne Tenezhdoll	Përfunduar
26	Riparimi i kanalizimit atmosferik në rr. Haxhi ZEKA	Përfunduar

f. Rrugët e përcjella në vitin 2012 për shkak të pengesave të ndryshme

Gjatë realizimit të një numri të projekteve komuna ka hasur në pengesa, kryesisht të natyrës pronësore, që kanë ndikuar në shtyrjen e tyre për vitin 2012. Këto probleme pronësore vijnë si rezultat i mungesës së dokumentacionin të qartë mbi pronën që nga periudha e pasluftës. Në tabelën në vijim janë dhënë këto projekte dhe arsyeja përkatëse.

Tabela 16: Projektet e bartura për vitin 2012 për shkak të problemeve pronësore

Nr.	Projekti	
1.	Ndërtimi i vazhdimit të rrugës Enver Maloku	Eksproprijimi i kësaj rruge është në procedurë deri te rruga Ndue Pertleshi
2.	Ndërtimi i rrugës paralele Prishtinë – Shkup	Punimet janë ndërpre, pritet eksproprijimi për të vazhduar punimet
3.	Rindërtimi i rr.Nue Perlleshi nga rr. M. Fejza deri te Qendra e Mjekësisë Familjare Mati 1	Punimet nuk kane filluar, pritet eksproprijimi për të vazhduar punimet
4.	Ndërtimi i rrugës "B"	Punimet kanë filluar, pritet eksproprijimi për të vazhduar punimet
5.	Ndërtimi i rrugës "B" faza e katërt	Është kontraktuar kompania ndërtuese, pritet eksproprijimi për të vazhduar punimet
6.	Ndërtimi i rrugs "Ibrahim Fehmiu"	Punimet kanë filluar, mirëpo për shkak të uzurpimeve punimet janë ndërprerë. Priten të zgjidhen problemet pronësore për vazhdimin e punimeve
7.	Ndërtimi i rr "Ahmet Krasniqi"	Punimet kanë filluar, mirëpo pas ndërhyrjes në projekt nga ana e Ambasadës Amerikane është bërë devijimi i trasesë së rrugës. Pritet të modifikohet projekti për të vazhduar punimet gjatë vitit 2012.

Ekzistojnë edhe disa projekte që përcillen për vitin 2012 për shkak të temperaturave të ultë për të vendosur shtresën përfundimtare të asfalti:

1. Rindërtimi i rr. Lidhëse me rr.Vëllezërit Fazliu dhe rr.Isa Kastrati,
2. Asfaltimi i rrugës ne lagjen " Kaqot " ne Keqekolle,
3. Asfaltimi i rrugëve Sinidoll - Bernicë (faza e pare),
4. Sanimi i disa rrugëve ne qytet dhe fshatra ne K.prishtines,
5. Ndërtimi i rrugës Qemal Stafa,
6. Rregullimi i kolektorit ne përroin Vellusha ne Taukbahqe,
7. Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në rrugën dhe Ndue Pertleshi,
8. Ndërtimi i rrugës " Tahir Zajmi",
9. Ndërtimi i rrugëve Flotacion - Lagja Vrajolle,
10. Ndërtimi i rrugës ne Mramor - lagjja Spahiaj,
11. Ndërtimi i rrugës Viti Bullaj,
12. Rregullimi i kolektorit nga rruga " Abedin Rexha deri te rruga " Ibrahim Fehmiu"
13. Zgjerimi i rrugës për skaj Ambasadës Amerikane,
14. Ndërtimi i mureve mbrojtëse në rrugën Tomori, Tutini 27 Nentori , Keqekolle – Kaqot,
15. Rindërtimi i disa rrugëve ne lagjen Arberia , Velani dhe Sofali,
16. Ndërtimi i rrugës " Ekrem Rexha".

g. Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2011 drejtorja ka shqyrtuar 1,066 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe banorëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike për leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa rreth çështjes së mirëmbajtjes së komplekseve banesore që nuk kanë qenë në kompetencë të drejtoratit, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa rreth definimit të zgjidhjes në teren etj. Të gjitha kërkesat e pranuar kanë marrë përgjigje.

12. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE DHE SHPËTIM

a. Sektori i Shërbimeve Publike

Gjatë vitit 2011, Sektori i Shërbimeve Publike ka realizuar detyrat e planifikuara për këtë periudhë. Ky sektor vëmendje të posaçme i ka kushtuar aktivitetet që kanë të bëjnë me transportin publik dhe mbikëqyrjen e projektit të sinjalizimit në përgjithësi, projektit për vendosjen e shenjave informuese dhe propozim-projektit për emërtimin e rrugëve, lagjeve dhe vendbanimeve, projektit për riorganizimin e parkingjeve publike të të gjitha llojeve, është ritenderuar dhënia në shfrytëzim e parkingut prapa Pallatit të Rinisë, është mbikëqyrë organizimi i transportit publik të udhëtarëve, është duke u punuar plani për riorganizimin e transportit të udhëtarëve me TAXI dhe vendparkimit të tyre, ndryshimit të Rregullores për Organizimin e Shërbimit të Transportit me TAXI dhe harmonizimin me Rregulloren për Organizimin e Transportit Publik të Udhëtarëve në territorin e Komunës së Prishtinës. Po ashtu është dërguar në prokurim projekti për kompanitë rimorkuese, i cili është në fazën e vlerësimit (shërbimi me marimangë).

Është hartuar projekti i Rregullores për Menagjimin e Mbeturinave, i cili pas amandamentimit të Ligjit për Menagjimin e Mbeturinave nga Kuvendi i Kosovës, do të procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës. Nga komisioni përkatës është hartuar Plani Strategjik 2012-2016 dhe Plani Lokal i Veprimit për Administrimi e Mbeturinave të Ngurta në Komunën e Prishtinës. Ky plan do të fillojë të implementohet në formë të pilot-projektit për lagjen Dardania në Prishtinë.

Ka vazhduar menaxhimi i mirëmbajtjes dimërore të rrugëve në qytet dhe në pjesën rurale. Për loton e parë të mirëmbajtjes është kontraktuar kompania "Zahiri". Kjo loto ka përfshirë 118 rrugë në vlerë prej 146,628.24€. Punët në loton e dytë i ka kryer SHPK "Toifor" në të cilën u përfshinë 82 rrugë në vlerë 206,569.61€. Mirëmbajtjen për loton e tretë e ka fituar NP "Pastrimi". Kjo loto ka përfshirë 95 rrugë në vlerë 143,541.82€. Në krahasim me vitin e kaluar, këtë vit janë përfshirë në mirëmbajtje 100 rrugë më shumë. Po ashtu mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale është bërë nga "VZ Compañi" në vlerë prej 15,20.00 € për loton e parë, ndërsa të dytën e ka kryer NNT "Dardania" në vlerë prej 72,00.00€, ndërsa mirëmbajtja verore e rrugëve rurale është bërë nga kompania "Kastrioti" në vlerë 69.750 E. Kjo kompani ka arritur të përmirësojë, grederojë dhe pastrojë 40 km rrugë rurale. Gjithashtu është realizuar mirëmbajtja-fshirja dhe larja e 146 rrugëve të qytetit dhe vetëm fshirja e 149 rrugëve dhe hapësira tjera të qytetit, po ashtu përmes tri kompanive.

DSHPMSH, përpos këtyre punëve, ka realizuar ose i ka në procedurë realizimi edhe këto projekte:

- mirëmbajtjen e semaforëve

- sinjalizimin vertikal dhe horizontal
- mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sipërfaqeve gjelbëruese(mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave tjera)
- mirëmbajtjen e ndriçimit publik(në dy loto-342 rrugë të qytetit)-aftësimi i rrjetit të ulët ndriçues (atij ekzistues)
- zgjerimin e ndriçimit publik në rrugët e pandriçuara të qytetit dhe të katër fshatrave
- zgjerimin e ndriçimit në parkut në Ulpianës dhe atij të Dardanisë
- ndriçimin e oborreve të 12 shkollave
- furnizimin dhe montimin i 1000 trupave ndriçues ekonomik
- riparimin i 12 ashensorëve-faza e dytë
- riparimi i 30 ashensorëve - faza e tretë(ky projekt është në realizim e sipër)
- furnizimin me 250 kontejner të vëllimit 1/1 m3
- pastrimin e hapësirave nga mbetjet ndërtimore-materialet inerte
- projektimi i deponime për deponimin e mbetjeve ndërtimore(materialeve inerte)
- modernizimi i nyjeve ekzistuese dhe ndërtimi i nyjeve të reja semaforike
- eliminimi i qenve endacak – faza e parë dhe
- trajtimi (kastrimi dhe sterilizimi) i qenve endacak,në procedurë

Sfidë kryesore edhe më tutje mbetet mungesa e parkingjeve publike, ngarkesa e madhe në trafikun e Prishtinës, shërbimi i transportit publik të udhëtarëve dhe ai i shërbimit me TAXI. Në këtë drejtim, sektori përkatës në bashkëpunim me policinë e Kosovës kanë operuar bashkërisht dhe kanë arritur që të mbajnë situatën nën kontroll,të eliminojnë shumë parregullsi,të operojnë bashkërisht në rregullimin e funksionimit të komunikacionit, të largojnë veturat e parkuara në mënyrë të parregullt dhe të vlerësojnë çdo ditë nevojën për të ndërhyrë sipas gjendjes së krijuar dhe kërkesave nga tereni.

Shërbimi për shfrytëzimin e hapësirave publike,sipas nevojave të qytetarëve dhe përfaqësuesve të bizneseve të ndryshme, ka shqyrtuar dhe miratuar kërkesat e ndryshme të shtruar nga të lartpërmendurit në përputhje me rregulloren përkatëse. Të hyrat e realizuara nga kjo drejtori gjatë vitit 2011 kanë për 30% më shumë se vitin e kaluar, si rezultat i menaxhimit më efikas të shfrytëzimit të hapësirave publike. Këto të hyra vijnë nga: parkingjet, shërbimi me “marimangë”, shfrytëzimi i hapësirës publike nga kafe/restorantet, ngarkesat e AMM për reklama, Parku i Gërmisë (laura) etj.

b. Sektori i mbrojtjes dhe shpëtimit

Shërbimet përkatëse në këtë sektor , gjatë kësaj periudhe , kanë hartuar Planin për Mbrojtje nga Zjarri për territorin e Komunës së Prishtinës i cili është aprovua nga kryetari i Komunës, Planin për Reagim Emergjent për territorin e Komunës , Planin për Reagim Emergjent për ndërtesën e re te Komunës, Planin Vjetor të Punës së KKSBS-ës dhe Dinamikën e kryerjes së punëve nga KKSBS-ja të cilin njëkohësisht e ka miratuar ky organ dhe Planin Operativ për Mbrojtje nga Zjarri gjatë fushatës së korrje- shirjeve. Po ashtu janë mbajtur trajnime me nxënësit e shkollave fillore dhe të punësuarit në ato institucione për evakuim në raste të fatkeqësive natyrore,me qrast është bërë demonstrimi praktik gjatë këtyre ushtrimeve dhe janë përgatitur materialet për nëntë mbledhjet e KKSBS-ës.

Shërbimi i planifikimit ka grumbulluar të dhënat për resurset humane nga ndërmarrjet publike dhe ato private për reagim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera në territorin e Komunës. Gjatë kësaj periudhe nga inspektorët e parandalimit dhe hulumtimit janë hartuar 78 raporte zjarri, 145 procesverbale, janë dhënë 806 masa për eliminimin e

dobësive subjekteve që veprojnë në territorin e Komunës, janë lëshuar 36 pëlqime në elaboratin për mbrojtje nga zjarri , janë dhënë 60 vërtetime palëve për nevojat e tyre personale dhe ` 8 konstatime për gjendjen e objekteve. Po ashtu inspektorët kanë inspektuar 18 shkolla fillore, 5 shkolla të mesme, 9 institucione parashkollore dhe 37 raste emergjente në bazë të kërkesave të qytetarëve. Ky shërbim ka lëshuar edhe 27 procesverbale me të cilat ka urdhëruar subjektet e ndryshme që të hartojnë Planet për Mbrojtje dhe Shpëtim me rastin e fatkeqësive në përputhje me afatin ligjor. Janë urdhëruar 104 masa tjera të afatizuara për të gjitha subjektet e vizituara janë hartuar e dërguar 29 procesverbale.

Vërshimet e shkaktuara nga reshjet e shiut të 22 majit në territorin e komunës shkaktuan dëme të konsiderueshme. Menjëherë, me propozim të DSHPMSH-ës është aktivizuar shtabi komunal i mbrojtjes dhe shpëtimit i cili ka marrë vendimin për formimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara si dhe ka monitoruar punën e këtij komisioni. Ky komision ka vizituar 212 familje të dëmtuara, tri ndërmarrje private dhe ka konstatuar vlerën e dëmeve prej 402.490,00€. Pas konstatimit të vlerës së dëmeve, komisioni ka monitoruar shpërndarjen e mjeteve në përqindje proporcionale nga Komuna e Prishtinës dhe Qeveria e Kosovës në vlerë prej 270.000 €.

Përpos punëve të lartshënuara, DSHPMSH në kuadër të këtij sektori ka planifikuar, ka realizuar dhe janë në procedurë realizimi këto projekte:

- ndërtimi i garazheve montuese në Kodër të Trimave
- renovimi i strehimoreve në Kodër të Diellit, Ulpianë dhe në Mat
- rregullimi dhe thurja e oborrit të BZP-ës (Baza e zjarrfikësve)
- furnizimi i BZP-ës me dy automjete të reja sulmuese
- montimi i 12 hidrantëve në pjesë të ndryshme të qytetit
- furnizimi me pajisje rezervë për BZP-ën
- furnizimi me uniformë dimërore për zjarrfikësit
- furnizimi me automjetin malor "Unimog", në procedurë tenderimi
- furnizimi i BZP-ës me kompresor dhe maska mbrojtëse dhe
- furnizimi me inventar i objektit të BZP-ës, në procedurë tenderimi

Edhe Qendra për Informim, Alarmim dhe Koordinim, si rëndom , ka organizuar kujdestarinë gjatë 24 orëve pa ndërprerë. Në këtë shërbim operatorët kujdestarë të marrin dhe japin informata të ndryshme nga qytetarët ,nga organet komunale dhe organet tjera shtetërore në çfarëdo kohe. Gjatë kësaj periudhe kohore, kjo Qendër është kujdesur për mirëmbajtjen e monitorëve në Komunë, ka mirëmbajtur radiolidhjet me BL-ët, ka bërë formatizimin e programit të sistemit të qasjes (hyrje - daljeve) në laurën e Parkut Regjional të Gërmisë, ka bërë verifikimin e të gjitha mjeteve teknike dhe radiolidhjeve. Gjatë kësaj periudhe janë punuar 182 kartela për shërbyesit civil dhe janë pranuar 2048 informata nga qytetarët dhe subjektet e ndryshme. Brigada e zjarrfikësve gjatë kësaj periudhe ka realizuar detyrat dhe obligimet që janë paraqitur nga fatkeqësitë elementare apo zjarret në territorin e Komunës së Prishtinës, Fushe Kosovës , Obiliqit dhe Graçanicës.

Për të ngritur shkallën e cilësisë profesionale të zjarrfikësve janë planifikuar dhe realizuar të gjitha trajnimet e planifikuara profesionale siç janë: "Trajnimi për ndihmë të parë" s realizuar në Vushtrri 4 (katër) zjarrfikës, "Trajnimin e avancuar dy mujor", 5 (pesë) zjarrfikës, "Trajnimin për menaxhimin e vijës së parë", 5 (pesë) zjarrfikës, "Trajnimin për ngasje emergjente dhe aksidente në komunikacion " 2 zjarrfikës, "Trajnimin për intervenime në zjarret fushoro-malore" 3 (tre) zjarrfikës, "Trajnimin për intervenime në zjarret e brendshme" 4 (katër) zjarrfikës, "Trajnim për intervenime në zonat urbane" 3 (tre) zjarrfikës

si dhe pjesëmarrja e 4 (katër) zjarrfikëseve në Republikën e Sllovenisë në ushtrimin "Kërkim - shpëtimi në zonat urbane " trajnim me karakter ndërkombëtar.

Tabela 17: Statistikat për intervenimet nga zjarrfikësit gjatë vitit 2011

Viti 2011	Dalje	Nr. i zjarreve	Int. teknike	Nr. i zj. pjesmarrës	Nr. i automjeteve	Orë pune	Të lënduar		Të vdekur	
							Qy	Zj.	Qy	Zj.
Janar	80	67	13	407	136	525:31	2	-	1	-
Shkurt	65	51	14	343	104	312:51	1	-	-	-
Mars	118	112	6	435	150	570:16	-	-	-	-
Prill	117	99	18	449	150	498:56	7	-	1	-
Maj	93	56	37	396	133	82:21	3	-	-	-
Qershor	64	43	21	274	98	265:40	-	-	-	-
Korrik	157	138	19	531	185	665:48	2	-	-	-
Gusht	358	331	27	1098	427	1783:28	-	-	-	-
Shtator	387	356	31	1180	428	1574:42	1	-	-	-
Tetor	95	83	12	385	130	331:55	1	-	-	-
Nëntor	135	119	16	597	192	1119:15	-	-	-	-
Dhjetor	70	45	25	307	102	298:52	-	-	2	-
Gjithsej	1739	1500	236	6402	2235	8031:34	17	-	4	-

Në kuadër të BZP-ës janë zhvilluar edhe aktivitete tjera të planifikuara që kanë të bëjnë me ngritjen profesionale (trajtime-pjesa teorike) dhe demonstrimet praktike të njohurive (mësimi praktik) si dhe punë të natyrës teknike të bëra nga shërbimi i mekanikëve për mirëmbajtjen e automjeteve. Ajo që e karakterizon vitin 2011 është rritja e daljeve të njësisve të zjarrfikësve për 53.76% , ose 608 dalje më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit paraprak.

Gjatë vitit 2011, janë pranuar 1,353 lëndë të cilat janë shqyrtuar si në vijim: aktvendime 216, njoftime 503, pëlqime 157, dërgim lënde 65, kërkesa të ndryshme 276, vërtetime 72, konstatime 12 dhe 12 janë në procedurë.

c. Bashkëpunimi dhe donacionet

DSHPMSH ka bashkëpunuar me GIZ-ën gjermane në fushën e menagjimit të mbeturinave komunale. Si rezultat i këtij bashkëpunimi janë realizuar rregullorja për menagjimin e mbeturinave komunale, plani strategjik dhe plani i veprimit, është realizuar një donacion prej 100 kontenierësh për kompaninë "Pastrimi", disa vizita në vende të ndryshme, janë bërë analizat gjashtëmujore të mbeturinave komunale, dhe përkrahje tjera për kompaninë "Pastrimi". Bashkëpunimi me Zyrën Japoneze në Kosovë (JICA) ka rezultuar me një donacion prej 10 kamionësh për bartjen e mbeturinave, i cili do të realizohet kah fundi i këtij viti kalendarik dhe i 50 autobusëve të transportit të udhëtarëve për nevoja të trafikut urban. Projekti i autobusëve do të fillojë të realizohet vitin e ardhshëm. Nga Banka Botërore kemi përfituar donacionin prej 70.000 € për pastrimin e Liqenit të Badocit, lumenjve që e furnizojnë këtë liqe dhe lumenjve që e furnizojnë Liqenin e Batllavës nga mbeturinat e të gjitha llojeve. Projekti ka qenë sezonal (tremujor) dhe ka punësuar 70 qytetarë të papunë. Në fushën e ndriçimit kemi realizuar projektin për ndërrimin 350 e trupave ndriçues ekonomik në disa rrugë të qytetit si donacion i USAID-it dhe Ministrisë së Energjetikës në vlerë prej 30.000 €.

13. DREJTORIA E KADASTRIT

Kjo drejtori në fushë-veprimtarinë e vet ka mirëmbajtjen e operatit kadastral ku përfshihen: regjistrimi i pronës së paluajtshme, korigjimin e regjistrimit të pronarëve, regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave, regjistrimin e banesave kolektive, pjesëve të etazhit si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të vendosura banesat kolektive, ndarjen dhe bashkimin e ngastrave, incizimin e gjendjes dhe përkufizimin e patundshmërive, mirëmbajtjen e shenjave gjeodezike, të ndarjeve të patundshmërive, ekspertizat e gjyqit, lëshimin e certifikatave mbi pronën e paluajtshme, kopjet e planit, lëshimin e vërtetimeve dhe certifikatave të ndryshme, zgjedhjen e kërkesave zyrtare nga gjykatat dhe institucionet të nivelit lokal dhe qendror dhe punët e tjera nga kompetencat të parapara më ligj, urdhëresa administrative dhe aktet të tjera nënligjore.

Angazhimi i drejtorisë kryesisht ka qenë ofrimi i shërbimeve më efikase për qytetarë duke garantuar të dhëna të azhurnuara për pronat dhe ruajtjen e tyre, si:

- Regjistrimi efektiv dhe i sigurt i pronave në Regjistrin të Drejtave për Posedim të Pronave (RDPP),
- Avancimi i metejme i funksionalizimit të mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit në modelin zyrtar,
- Vazhdimin e matjeve kadastrale në teren sipas sistemit zyrtar “KosovaReff01”,
- Kontrollimin e kualitetit të të dhënave para se të filloi shfrytëzimi i tyre,
- Sistemin e përgatitjes së të dhënave nga baza grafike dhe tekstuale,
- Arkivimi i rregullt i të dhënave kadastrale në bazën qendrore dhe lokale, etj.

Gjate vitit 2011, Drejtoria e Kadastrit ka realizuar disa projekte.

1. Është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit i nënshkruar në mes të Komunës së Prishtinës dhe Organizatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – GIZ-së për projektin “Menaxhimi i tokës/kadastrit në Kosovë”. Projekti ka filluar të realizohet nga data 13.04.2011 dhe përfshinë:
 - Punësimin dhe financimin e 2 ekspertëve vendor për GIS/Kadastër,
 - Punësimin dhe financimin e një eksperti ndërkombëtar për GIS/Kadastër, i cili ndihmon dhe përkrah herë pas herë edhe Drejtorinë e Kadastrit nga qershorit i vitit 2011,
 - Sigurimin i infrastrukturës dhe pajisjeve të nevojshme për ekspertët e angazhuar,
 - Këshillimi i Drejtorisë gjatë konsolidimit të të dhënave ekzistuese grafike,
 - Implementimi i masave trajnuese pranë drejtorisë,
 - Përkrahja e Drejtorisë për optimalizimin e proceseve të punës,
 - Hulimtimi i të dhënave bazë statistikore për kohëzgjatjen e një regjistrimi, përqindjen e pajtueshmërisë së të dhënave kadastrale dhe atyre të librave të regjistrimit me situatën reale, të përqindjes së dhënies së punëve matëse firmave private gjeodezike etj.
2. Krijimi i Kadastrit Nëntokësor (përçojat dhe objektet nëntokësore), ku në kuadër të këtij projekti (një pjesë e unazës së brendshme) janë incizuar 263,158 km gjatësi të gjendjes faktike deri në krijimin e modelit digjital (GIS), matje 3D (XYZ) për të gjitha pusetat, objektet nëntokësore që kalojnë përçojat nëntokësore, mbledhja e informacioneve drejtpërdrejt në terren për pozicionin e saktë të linjave nëntokësore (kabllove, gypa, fibra optik, gypa të gatshëm për shfrytëzim), përcaktimi i diametrit

të gypave nëntokësor si dhe futja e këtyre informacioneve në modelin dixhital të krijuar paraprakisht. Si rezultat përfundimtar i këtij projekti është parapare një model digjital, i cili do të shërbej si bazë për futjen e informacioneve për përçojat, linjat nëntokësore dhe mbledhjen e informacioneve për një gjatësi të infrastrukturës në kuadër të zonës së caktuar.

3. Kadastru i Ndërtesave (Regjistrimi i Kadastrit etazhor) përmes projektit të Bankës Botërore për regjistrimin e kadastrit të ndërtesave. Projekti është realizuar me operator ekonomik privat, ku janë pranuar 8,024 aplikacione për zonën kadastrave 'Pristinë' dhe zonën kadastrave 'Matiqan'. Deri më tani janë përfunduar-regjistruar 7,644 banesa dhe lokale afariste, të cilat janë menaxhuar, kompletuar dhe miratuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës (AKK). Lëndët të cilat (sipas dosjeve) kanë qenë të pa kompletuar do të trajtohen pas kompletimit të tyre.
4. Rindërtimi i informacioneve kadastrave përmes financimit të Bankës Botërore, të përkrahur e mbikëqyrur edhe nga Agjencioni Kadastral i Kosovës me qëllim të rindërtimit të informacionit kadastral për zonat: Sofali, Kolovicë dhe Shkabaj. Ndërsa për zonat kadastrale Bardhosh dhe Bernicë e Epërme, projekti është financuar buxheti i Kosovës, gjegjësisht Agjencioni Kadastral i Kosovës.
5. Furnizimi me instrumentin "GPS" dhe një instrumenti "Stacion Total" për rritjen e efikasitetit të matjeve gjeodezike në terren, e cila gjë ka mundësuar procesimin efikas të 1,617 lëndëve për terren. Vetëm 31 lëndë kanë mbetur të pakryera deri më tani, të cilat do të kryhen në fillim të vitit 2012.

Gjatë vitit 2011, është kryer auditimi i brendshëm i drejtorisë për aktivitetet e kryera gjatë vitin 2010 dhe drejtorja është në pritje të raportit përfundimtar nga zyra e auditimit të brendshëm e komunës. Drejtorja ka vazhduar bashkëpunimin shumë të mirë me Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK) dhe si rezultat kemi realizimin e disa projekteve të lartshënuara.

Punët gjeodezike në terren gjatë vitit 2011 janë realizuar 60% nga sektori privat, ndërsa 40% nga komuna. Koha mesatare e realizimit të lëndëve (bartje) ka qenë 26 ditë (duke llogaritur edhe kohën prej 5 ditë pune për shpalljen publike). Mosrealizimi i të hyrave të planifikuara sipas planit të punës ka ardhur për shkak të: transaksioneve të shitblerjeve me çmime fiktive të përcaktuara me vullnetin e lirë të palëve e jo sipas çmimeve të tregut dhe shkëputjes së 5 zonave kadastrave sipas "Planit të Ahtisarit" që janë bartur në Komunën e Graçanicës.

Në drejtori kanë arritur një numër i madhe i kërkesave për realizimin e të drejtave pronësore nga persona fizik, juridik, gjykatat, AKK dhe AKP. Numri i lëndëve (kërkesa, ndarje, certifikata etj.) gjatë vitit ka qenë 40,919, nga të cilat janë realizuar 40,799 ose 99.7%, ndërsa në procedurë kanë mbetur 110 lëndë ose 0.29%. Në vazhdim është paraqitur gjendjen e lëndëve të arritura, të aprovuar dhe lëndët të cilët janë në procedurë.

Drejtorja ka trajtuar edhe një numër të lëndëve të mbetura nga vitit 2010: bartje 80 lëndë, konkluzione 192 lëndë, matje gjeodezike 31 lëndë, korrigjime 13 lëndë dhe refuzime 3 lëndë.

Tabela 18: Tabela e lëndëve për vitin 2011

	Pranuar	Aprovuar	Në Procedurë
Fletë poseduese dhe kopje e planit	15,890	15,890	0
Certifikata/Vërtetime	19,987	19,987	0
RDPP-bartje	2,308	2,228	70
Korrigjime të të dhënave	60	51	9
Hipoteka-regjistrim dhe akte plotësuese	635	635	0
Hipo-çregjistrim	422	422	0
Ndarje e parcelave dhe etazheve	737	706	31
Incizimi i ndërtesave-banesave	6	6	0
Incizimi i shtëpive individuale	27	27	0
Përcaktimi i kufirit- matjeve	11	11	0
Bashkimi i parcelave	24	24	0
Ekspertiza	8	8	0
Identifikimi i parcelave	5	5	0
Dhënia e produkteve	47	47	0
Kërkesa-Institucionet	299	299	0
Të ndryshme	453	453	0
Gjithsej	40,919	40,799	110

Nga të dhënat e paraqitura më lartë, për Drejtorinë e Kadastrit bazuar në efikasitetin e realizimit të projekteve dhe kërkesave ka qenë një vit shumë i suksesshëm. Megjithatë, ende mbeten problem mosrealizimi i lëndëve të pazgjedhura pronëso-ro-juridike me vendime të ndryshme të gjykatave, të cilat kanë lidhshmëri (kufizime) nga Agjencioni Kosovar i Pronave. Drejtoria ka nevojë për trajnimin e stafit në fusha të caktuara si dhe ka mungesë të disa pajisjeve për terren, të cilat do të adresohen gjatë vitit 2012.

14. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

a. Sektori Komunal dhe i Komunikacionit

Aktiviteti i Drejtorisë së Inspektionit gjatë periudhës raportuese është orientuar në inspektimin e zbatimit të ligjit dhe të rregulloreve të miratuara në Kuvendin Komunal që kanë të bëjnë me: ndërtimtarinë, tregtinë, veprimtaritë komunale dhe të komunikacionit, bujqësinë, veterinarinë dhe sanitarinë. Janë kryer edhe punë të tjera në bazë të urdhëresave të organeve kompetente komunale, në bazë të kërkesave të qytetarëve, të ndërmarrjeve komunale si dhe në bazë të kërkesave të policisë. Në kuadër të Drejtorisë të Inspektionit për periudhën raportuese kanë qenë të angazhuar 46 zyrtarë si dhe 5 punonjës të sektorit të tregut, pra gjithsej 51 punëtorë në: sektorin e ndërtimtarisë, sektorin komunal dhe të komunikacionit, sektorin e tregtisë dhe bujqësisë, dhe sektorin e sanitarisë dhe veterinarisë.

b. Sektori i inspektionit të ndërtimit

Në bazë të Ligjit për ndërtimin dhe në bazë të Udhëzimeve administrative, është bërë inspektimi i ndërtimeve në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe janë marrë masa ligjore për raste të ndryshme të ndërtimeve pa leje. Gjatë vitit 2011, ky sektor ka identifikuar 390 ndërtime pa leje, kur përfshihen të gjitha llojet e ndërtimeve (garazhe, anekse të ndryshme, kate shtesë etj.). Të gjitha këto janë trajtuar nga inspektorët. Prej tyre 109 janë rrënuar nga komuna, 5 janë rrënuar nga vetë pronarët, janë nxjerrë 155 aktvendime për rrënim, 376 aktvendime për ndërprerje të punës dhe janë lëshuar 2 urdhëresa.

c. Sektori i Inspektionit Komunal dhe të Komunikacionit

Ky sektor ka qenë i angazhuar në largimit nga rruga, trotuaret dhe hapësirat e tjera publike të shitësve ambulantë, përreth tregut të gjelbër, tregut në lagjen Ulpiana, përgjatë rrugëve “Nëna Terezë”, “Bulevardi i Dëshmorëve“, “Ilir Konushevci“ etj. Po ashtu, me aksione të përbashkëta me Drejtorinë e Financave dhe të Pronës, është bërë lirimi i pronave publike-komunale nga uzurpuesit në “Qendër”, përkatësisht në rrugët “Agim Ramadani”, Bulevardi “Nëna Terezë” , “Luan Haradinaj” dhe “Fehmi Agani” dhe rrugët lidhëse me këto rrugë. Aksionet e tilla do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2012. Në vijim është lista e lëndëve të inspektionit komunal dhe të komunikacionit.

Tabela 19: Paraqitja e lëndëve të Inspektionit Komunal dhe të Komunikacionit

Inspektioni komunal		Inspektioni i komunikacionit	
Kontrollime	7,257	Lëndë të pranuar	1,593
Procesverbale	1,877	Asistime, ankesa njoftime etj.	56
Aktvendime	518	Procesverbale	1,537
Fletëparaqitje për gjykatë	157	Lëndë për gjykatë	1,537
Kërkesa	220	Lëndë të përfunduara nga Gj.K.K.	465
Njoftime	288	Dënime	365
Akt-përcjellës	50	Overtime	35
Fletëthirrje	145	Pezullime	61
Mungesë e njërive policore sipas planit operativ	33	Lëndë të kthvera	10
Largimi i shitësve ambulant	85	Lëndë në procedurë	04
Aksion me SHPK-në	73		
Aksion me PK në trafik	19 ditë		
Aksion për largim të drurëve	20 ditë		
Kundërvajtje të ndryshme në trafik	41		
Konfiskim i mallit	5		
Aksion për evidentimin e shtojcave	248		
Shpërndarje të urdhërësive	247		
Shpërndarje të vendimeve për shkallë	91		
Largimi i tarracave, rrethojave, reklamave, anekseve, mbulojave, tendave, zinxhirëve të metaltë, shtyllave ndriçuese, gjeneratorit, shkallëve, kontejnerëve, vazove etj.	524		

Në këtë vit do vepohet bazuar në planin e punës në ndalimin dhe parandalimin e operatorëve ilegal që operojnë ilegalisht në transportin e udhëtarëve.

d. Inspektioni sanitar dhe veterinar

Aktiviteti i përhershëm i këtij sektori zhvillohet në drejtim të preventivit dhe të mbrojtjes së shëndetit publik të popullatës nga sëmundjet e ndryshme infektive, pastaj në edukimin e popullatës për të aplikuar kulturën dhe masat mbrojtëse higjienë-sanitare, në ambientin jetësor.

Gjatë periudhës raportuese në kuadër të këtij sektori ka pasur 2467 kontrollime. Prej tyre janë përgatitur 1001 procesverbale, janë nxjerrë 132 aktvendime, 174 rekomandime sanitare, 51 fletëparaqitje për kundërvajtje, 108 fletë-urdhëresa, janë marrë 36 mostra të ushqimit etj. Malli i asgjësuar kap vlerën prej 362,038 €. Shërbimi veterinar ka zhvilluar ka kontrolluar mishin dhe produktet e mishit, qumështit dhe produkteve me prejardhje shtazore dhe ka bërë kontrollimin e zbatimit të ligjit mbi vaksinimin dhe rivaksinimin e shtazëve të mëdha dhe të imëta, qeneve dhe maceve në qytet si dhe dhënia – lëshimi i kartave të identitetit (pasaportave e qeneve dhe maceve).

Tabela 20: Paraqitja e raportit të sektorit Sanitar dhe Veterinar

Kontrollime	2,467
Procesverbale	1,001
Aktvendime	132
Rekomandime Sanitare	174
Fletëparaqitje për kundërvajtje	51
Shërbime tjera	/
Fletë-urdhëresa	108
Delikt ekonomik	/
Dënime nga gjykata	/
Kërkesa të palëve	24
Pëlqime për pranimin e lokaleve	493
Mostra të ushqimit	36
Mostra te ujit	/
Hotelieri	16
Farmaci	11
Inspektim i punkteve shëndetësore	08
Exumime jashtë vendit	05
Strisha	52
D.D.D.	33
Janë therë dhe vulosë me vulë shtetërore: dema dhe viça	104

e. Sektori i Tregut dhe Bujqësisë

Gjatë periudhës raportuese, inspektorët e sektorit të tregut dhe bujqësisë kanë qenë të angazhuar në kryerjen e punëve dhe detyrave sipas plan-programit vjetor të punës të cilat dalin nga autorizimet e akteve Ligjore dhe nënligjore, udhëzimeve administrative, urdhëresave dhe kërkesave të kryetarit të Komunës, shefit të personelit dhe administratës, Drejtorit të Inspektionit dhe kërkesave të qytetarëve. Gjithashtu kontrollimin e mallrave me prejardhje bimore – afatin e qëndrueshmërisë, cilësinë, sasinë dhe deklarimin e tyre dhe asgjësimin e mallit me afat të skaduar sipas ligjit mbi ushqimin. Gjatë periudhës raportuese ka pasur 3,769 kontrollime.

Tabela 21: Paraqitja e raportit të lëndëve të sektorit tregut dhe bujqësisë

Gjithsej Kontrollime	3,769
Procesverbale	2,882
Tregti	2,176
Zejtari	41
Hotelieri	936
Shërbime tjera	616
Kundërvajtje	61
Aktvendime	33
Pëlqime për kushte minimale teknike	684
Sasia e mallit të asgjësuar – në litra	1,475 litra
Sasia e mallit të asgjësuar – në kg.	55,888 kg
Urdhëresa me shkrim dhe me gojë	815
Nr. i objekteve të mbyllura përkohësisht	31
Largim shitësve nga rruga	37
Ankesa të qytetarëve	36